



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. 12/30 Prot.

Tiranë më 10/01/2024

V E N D I M

Nr.4 Datë 18/12/2023

Trupa e vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Arben Sefaj	Kryesues
Denisa Sina	Relator
Suela Bulku	Anëtar

Asistuar nga anëtarja e Sekretariatit Teknik, Ersila Kalaja, më datë 18.12.2023, ora 09:00, në Tiranë, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, salla e mbledhjeve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore çështjen që i përket:

SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT: **Z.Edmond Reis Sulaj**, me funksion Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

Rregullore nr.197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AMP-së

Pasi dëgjoi gjetjet, bazuar në arsyetimin ligjor si dhe rekomandimin e relatores së çështjes Denisa Sina vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit; pasi dëgjoi subjektin e vlerësimit Edmond Sulaj i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë; pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të Ligjit nr.12/2018 të ndryshuar,

VËREN:

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore në vazhdim (AMP), është organi kompetent që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Agjencisë Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6, të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 05.04.2023, si “Drejtor i Drejtorisë për Krimet Kundër Personit dhe Pasurisë” në DPPSH.

Me Urdhërin nr. 3023, datë 29.06.2023, është transferuar në detyrën Drejtor i Drejtorisë për Hetimin e Krimeve të Rënda në DPPSH.

Me Urdhërin nr. 6108, datë 11.10.2023, transferohet në detyrën, Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër.

Subjekti i vlerësimit, **Edmond Reis Sulaj**, iu nënshtroi procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar në datë 05.04.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.7, datë 17.01.2023, “Për procedurat e hedhjes së shortit”.

Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin (nr.1, datë 18.04.2023), u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: Znj.Denisa Sina (Relator), Z. Arben Sefaj (Kryesues) dhe Znj. Suela Bulku (Anëtare).

Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar, si edhe në bazë të Rregullores nr.197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin nr.1, datë 18.04.2023 vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit **Z. Edmond Reis Sulaj**.

Relatori i çështjes, Znj.Denisa Sina nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 18.04.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, ku i është bërë e njohur

përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e Trupës së Vlerësimit.

Më datë 19.04.2023, janë dërguar formularët e administruar nga ana e relatorit e konkretisht:

- ✓ Me shkresën nr.12/7 prot., datë 19.04.2023, është dërguar formulari i deklarimit të pasurisë pranë ILDKPKI.
- ✓ Me shkresën nr. 12/8 prot., datë 19.04.2023, është dërguar formulari i deklarimit të aftësive profesionale.
- ✓ Me shkresën nr. 12/9 prot., datë 19.04.2023, është dërguar formulari mbi deklaratën e kontrollit të figurës.

Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore në datë 22.04.2023 duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.

Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.

Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.

Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, ka për objekt:

- ✚ Vlerësimin e pasurisë;
- ✚ Kontrollin e figurës;
- ✚ Vlerësimin e aftësive profesionale.

Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:

- a. Ligji nr.12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
- b. Ligji nr.128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.
- c. Ligji nr.40/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”.
- d. Ligji nr.9367 datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”.
- e. Udhëzim i Ministrit të Brendshëm nr.7 datë 17.01.2023, “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar”.
- f. Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe ILDKPKI, me nr. 15, datë 27.01.2023, “Për miratimin e formularëve të deklarimit të pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.
- g. Rregulloren nr.197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”.

Gjithashtu Trupa e Vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:

- ✚ Deklarata e Pasurisë,
- ✚ Deklarata për Kontrollin e Figurës,
- ✚ Formulari i Vlerësimit Profesional,
- ✚ Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklarinimet,
- ✚ Raportin e Vlerësimit të Pasurisë nga ILDKPKI,
- ✚ Raportin e Vlerësimit të Figurës nga AMP,
- ✚ Raportin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale nga DPPSH,
- ✚ Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.
- ✚ Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.
- ✚ Ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gadishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.

Trupa e vlerësimit, më datë 04.12.2023, pasi dëgjoi relatorin dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z.Edmond Sulaj, me Vendimin nr. 3, datë 04.12.2023, vendosi;

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Z.Edmond Sulaj.
- b. Të njoftojë në rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - ✚ Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht,
 - ✚ Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional,
- c. Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5, i Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 34, pika 1, e Ligjit nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

1. Në datën 13.12.2023, Trupa e Vlerësimit nëpërmjet kryesuesit të seancës, njoftoi subjektin e vlerësimit për mbajtjen e seancës dëgjimore në datën 18 Dhjetor, ora 09:00, në ambientet e Ministrisë së Brendshme në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit nr.12/2018 (i ndryshuar).

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit Edmond Sulaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si dhe Kodin e Procedurave Administrative.

Subjekti i vlerësimit nuk kishte zgjedhur mbrojtës ligjor. Gjatë seancës dëgjimore, pas fjalës së relatorit, subjekti i vlerësimit parashtrroi disa shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi

procesin e vlerësimit në tërësi të kryer ndaj tij (të regjistruar në materialin audio në seancë dëgjimore). Në fund të seancës dëgjimore datë 18.12.2023, subjekti i vlerësimit Edmond Reis Sulaj, kërkoi konfirmimin në detyrë dhe Trupa e Vlerësimit shpalli vendimin në datë 18.12.2023.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

- ❖ Subjekti i vlerësimi Edmond Reis Sulaj ka qenë bashkëpunues dhe korrekt gjatë gjithë procesit të vlerësimit në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të Ligjit të Vlerësimit nr.12.2018 (i ndryshuar);
- ❖ Subjekti ka paraqitur që në fazën e dorëzimit të deklaratave edhe dokumentacion shoqërues të vlerësuar nga ana e tij, si dhe gjatë fazës së hetimit administrativ, gjatë komunikimit dhe pyetjeve të drejtuara nga relatori, është përgjigjur dhe ka përcjellë dokumentacion shoqërues/justifikues shtesë, me qëllim vërtetësinë e deklaratimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, sipas rastit dhe rrethanave të tjera të çështjes për sqarim, i kërkuar nga ana e relatorit.

IV – A) VLERËSIMI I PASURISË

- ✚ Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31, të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
- ✚ Në zbatim të nenit 32, pika 2, e ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit Z.Edmond Sulaj ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 09.03.2023. Formulari i Pasurisë mban nr. **16 index datë 09.03.2023**
- ✚ Procedurat e deklarinimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32, nenit 33, ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

Trupa e vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:

- Deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur.
- Raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI.
- Provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.
- Dokumentacionin e paraqitur në deklarinimet e subjektit, si përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklarinimet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, në zbatim të neneve 33/1 dhe 34, shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.

Hetimi administrativ konsistoi në:

- ✓ Verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ Verifikimin e burimit/ëve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara, si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ Evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ Evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme, si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

ILDKPKI-ja, në përputhje me Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publik”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në Ligjin Nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit **Z. Edmond Reis Sulaj**.

A) I. DEKLARATA E PASURISË

Në zbatim të nenit 32, të Ligjit nr. 12/2018, subjekti i vlerësimit i nënshtrohet procesit të vlerësimit kalimtar për periudhën e vlerësimit të deklaratës së pasurisë nga data e fillimit të marrëdhënies së punës në institucionin përkatës, deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë. Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si më poshtë vijon:

Pasuria nr 1. Apartament me sipërfaqe 62 m², e regjistruar në ZVRPP-në Tiranë blerë sipas kontratës së shitblerjes me nr. ***, rep, nr.**, kol, datë 25.01.2001.

Burimi i krijimit: Me të ardhura nga kursimet dhe marrë hua. **Vlera:** 3.000.000 lekë. **Pjesa takuese:** 50 %.

1. Trupa e vlerësimit për vërtetimin e faktit administroi:

- Kontratë shitje e një apartamenti, nr. 267 rep, nr.56 kol, datë 25.01.2001, nënshkruar midis palës shitëse F.D, A.R, E.K (përfaqësuar me prokurë nga shtetasi I.M) dhe palës blerëse Edmond Sulaj, për blerjen e apartamentit me sip. 62 m², me vlerë 3.000.000 lekë. Pagesa është kryer jashtë zyrës noteriale, vërtetuar kjo nëpërmjet nënshkrimit të kontratës nga të dyja palët.
- Deklaratë noteriale me nr.*** rep, nr.*** kol., datë 06.03.2023, e shtetasit A.R.

Hetimi administrativ

❖ **ASHK , Drejtoria Vendore Tiranë Jug**, me shkresën nr ** prot., datë 26.06.2023 konfirmon se nga verifikimet e kryera, referuar kompetencës territoriale pjesë e së cilës është edhe ZK ***

konfirmon se nuk rezulton të administrohet praktikë në emër të Edmond Reis Sulaj dhe personave të lidhur me të.

- ❖ Më tej, bazuar në deklarin e subjektit në deklaratën Vetting, subjektit i janë drejtuar pyetje në lidhje me pasurinë e sipërpërmendur. Në procesverbalin e datës 17.07.2023, pranë ILDKPKI, lidhur me likuidimin periodik të shlyerjes së huasë, subjekti ka sqaruar se përfitimi i shumës nga shtetasi A.R, nuk i është dhënë mbi bazën e ndonjë dokumenti noterial të kohës. Për këtë arsye shlyerja e këtij detyrimi nuk është bërë mbi bazën e ndonjë akti (mandat pagese, arkëtim), por është shlyer ndër vite sipas mundësive financiare që kanë pasur familjarisht.
- ❖ Në deklaratën noteriale nr **** rep, nr.*** kol, datë 06.03.2023, (bashkëlidhur formularit të deklaramit) shtetasi A.R. deklaroi se, ka nënshkruar një kontratë shitje apartamenti me subjektin. Objekt i kontratës ka qënë një apartament me sip.62 m2. Vlera e Shitjes së apartamentit 3.000.000 lekë. Në momentin e negociimit të kontratës familja Sulaj kishte mundësi të likujdonte vetëm shumën prej 1.000.000 lekësh. *Bazuar në raportet e ngushta familjare dhe në mirëbesim të plotë dakordësuam që vlerën e palikujduar prej 2.000.000 lekësh, tja jepja hua pa asnjë interes, hua e cila do të kthehej në vite sipas mundësive financiare të tij dhe bashkëshortes. Mbi këtë bazë familja Sulaj shleu detyrimin e plotë për blerjen e apartamentit. Vlerën prej 2.000.000 lekësh, ja kam dhënë cash Edmond Sulaj dhe për këtë nuk hartuam ndonjë kontratë noteriale huaje. Vlera prej 2.000.000 lekësh ka filluar të likujdohet me këste përgjatë viteve në vijim dhe në vitin 2017, kjo shumë është likujduar tërësisht.*
- ❖ I pyetur lidhur me dhënien fizike monetare të huasë, në kushtet kur personi huadhënës ka qënë pala shitëse pjesëmarrëse në kontratë, subjekti sqaroi se, referuar kontratës së shitjes në cilësinë e shitësit kanë qënë tre persona (të përmendur më sipër), të cilët rezultonin se ishin investitorët e godinës. Në këto kushte blerësi ka rënë dakort me shitësin A.R. që shumën prej 2.000.000 lekësh tja likujdojë dy pronarëve të tjerë duke qënë se ata kërkonin likuidim të menjëhershëm, përpara nënshkrimit të kontratës dhe kjo pagesë konfirmohet nëpërmjet deklaratës noteriale nr.***, rep. dhe nr.****, kol., nënshkruar nga përfaqësuesi i palës shitëse, i cili deklaroi se kjo shumë është likujduar dhe i është shpërndarë shitësve në mënyrë të barabartë.
- ❖ I pyetur në lidhje me burimin financiar të shitësit, në cilësinë e huadhënësit, subjekti ka dhënë sqarime se në atë periudhë kohore, përpara momentit të dhënies hua të shumës 2.000.000 lekë, nga ana e huadhënësit dhe dy pronarëve të tjerë të truallit ku është ndërtuar kjo godinë, janë kryer disa transaksione financiare nga palë të treta për shitjen e njërive të vecanta. Këto shuma të përfituara janë ndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet tre investitorëve, provuar kjo me kontratat që subjekti ka paraqitur pranë ILDKPKI, ku ka deklaruar se huaja është shlyer sipas mundësive që dispononte, duke filluar nga viti 2005, deri në vitin 2017, në shumën prej 100.000 lekë, përveç vitit 2012, kur ka shitur automjetin Fiat Punto dhe të ardhurat prej 200.000 lekë, i ka përdorur për të shlyer huanë. Në vitin 2014, për të shlyer një pjesë të huasë janë përdorur fondet e tërhequra nga bashkëshortja në shumën 5000 euro. Sqaroi gjithashtu se, pala huadhënëse ka patur mundësi financiare duke qënë në marrëdhënie biznesi dhe nuk ka patur nevojë për likuidimin e shpejtë të huasë.
- ❖ Qëllimi i paraqitjes së AMTP në dokumentacionin shoqërues të deklaratës së pasurisë së vlerësimit kalimtar, ka qënë për të provuar mundësinë financiare të prindërve të tij R.S. dhe R.S. për dhënien e dhuratës prej 100.000 lekë, me rastin e blerjes së shtëpisë së re në vitin 2001. Prindërit përveç pensionit kanë patur të ardhura nga produktet bujqësore e blegtorale dhe bletarisë.
- ❖ I pyetur për shpenzimet e mobilimit të këtij apartamenti sqaroi se, nga momenti i blerjes deri në vitin 2003, nuk ka kryer punime pasi ka qënë i përfunduar, ndërsa për mobilim shumën prej 800.000 lekësh, e ka shpenzuar ndër vite por nuk ka ruajtur fatura.
- ❖ I pyetur nga relatori për gjeneralitetin e sakta të personit palë huadhënëse, lidhjet familjare me z. A.R., në emailin e datës 18.10.2023, subjekti ka vënë në dispozicion kartën ID nr.***, në emër të

A.R i datëlindjes *****, si dhe ka sqaruar se ekziston një lidhje e fortë familjare mes tyre dhe qëllimi i blerjes së apartamentit në atë pallat dhe dhënia hua e shumës së mësipërme, ka qenë pikërisht për shkak të këtij raporti.

- ❖ I pyetur në lidhje me prokurën e posaçme të përfaqësuesit të palës shitëse të këtij apartamenti, Z.I.M, subjekti ka vënë në dispozicion të trupës prokurën e posaçme me nr**** rep., nr *** kol datë ****, si dhe pasaportë diplomatike në emër të tij.

Subjekti ka paraqitur dokumentacion provues si më poshtë:

- Deklaratë Noteriale e shtetasit I.M., i cili deklaroi se në cilësinë e përfaqësuesit të investitorëve në ndërtim A.R, F. D. dhe E.K, ka nënshkruar kontratën e shitjes nr. *** rep., nr . *** kol, datë. **, për shitje apartamenti me vlerë 3.000.000 lekë shumë e cila është shlyer cash përpara hartimit të kontratës shlyer jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë shitje datë 01.02.2000, nga ana e investitorëve, ndër të cilët A.R, është shitur një njësi me vlerën 1.582.2000 lekë, shlyer jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë shitje datë 01.02.2000, nga ana e investitorëve, ndër të cilët A.R, është shitur një njësi me vlerën 1.800.000 lekë, shlyer jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë shitje datë 01.12.2000, nga ana e investitorëve, ndër të cilët A.R, është shitur një njësi me vlerën 2.800.000 lekë, shlyer jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë shitje datë 20.12.2000, nga ana e investitorëve, ndër të cilët A.R., është shitur një njësi me vlerën 1.800.000 lekë shlyer jashtë zyrës noteriale
- Kontratë shitje, datë 20.12.2000, nga ana e investitorëve, ndër të cilët A.R, është shitur një njësi me vlerën 3.800.000 lekë, shlyer jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë shitje datë 20.12.2000, nga ana e investitorëve, ndër të cilët A.R, është shitur një njësi me vlerën 1.900.000 lekë, shlyer jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë shitje datë 20.12.2000, nga ana e investitorëve, ndër të cilët A.R, është shitur një njësi me vlerën 3.800.000 lekë, shlyer jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë shitje datë 20.12.2000, nga ana e investitorëve, ndër të cilët A.R, është shitur një njësi me vlerën 3.200.000 lekë, shlyer jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë shitje datë 20.12.2000, nga ana e investitorëve, ndër të cilët A.R, është shitur një njësi me vlerën 1.800.000 lekë, shlyer jashtë zyrës noteriale
- Kontratë shitje datë 20.12.2000, nga ana e investitorëve, ndër të cilët AR, është shitur një njësi me vlerën 3.000.000 lekë shlyer, jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë shitje datë 23.12.2000, nga ana e investitorëve, ndër të cilët A.R, është shitur një njësi me vlerën 1.800.000 lekë, shlyer jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë shitje datë 23.12.2000, nga ana e investitorëve, ndër të cilët A.R, është shitur një njësi me vlerën 1.800.000 lekë, shlyer jashtë zyrës noteriale
- Kontratë shitje datë 29.12.2000, nga ana e investitorëve, ndër të cilët A.R, është shitur një njësi me vlerën 1.600.000 lekë, shlyer jashtë zyrës noteriale
- Kontratë shitje datë 29.12.2000, nga ana e investitorëve, ndër të cilët A.R, është shitur një njësi me vlerën 1.800.000 lekë, shlyer jashtë zyrës noteriale
- Kontratë shitje datë 15.01.2001, nga ana e investitorëve, ndër të cilët A.R, është shitur një njësi me vlerën 1.500.000 lekë, shlyer jashtë zyrës noteriale.
- Vërtetim nr.303 prot., datë 19.06.2023, nga Bashkia Himarë për shtetasin R. Sulaj, i cili ka qenë me vendbanim Kuc, Vlorë, deri në vitin 1999. Në bazë të ligjit nr.7501, referuar AMTP në pronësi nr.,****, datë 20.02.1994, ka përfituar gjithsej 8.050 m² tokë bujqësore.

- Vërtetim nr. Ekstra Prot., datë 17.06.2023, nga Bashkia Himarë Njësia Administrative Horë-Vranisht, me anë të të cilit vërtetohet se shtetasi R. Sulaj ka përfituar 8050 m², tokë bujqësore me ligjin 7501.
 - Deklaratë e shtetasit E. Sulaj i cili deklaroi se në Janar 2001 i ka dhënë vëllait Edmond Sulaj 50.000 lekë për blerjen e shtëpisë.
 - Kartelë personale e shtetasit Elmas Sulaj , Kryekomisar në Gardën e Republikës, në të cilën evidentohen funksionet nga viti 1989-2023.
 - Shkresë kthim përgjigje datë.22.06.2023 nga ISSH, Drejtoria e Arkivit Qëndror drejtuar shtetasit Elmas Sulaj, në të cilën evidentohen pagat e përfituara gjatë periudhës 1994-2000.
 - Vërtetim datë 27.02.2023 nga DRSSH Tiranë me anë të të cilit vërtetohet se shtetasja Rakibe Sulaj trajtohet me pension pleqërie në masën mujore 11.726 lekë. Të ardhurat në total për periudhën 17.06.1992-28.02.2023 janë 2.056.145 lekë dhe në periudhën deri Dhjetor 2000, të ardhurat rezultojnë të jenë 112.000 lekë.
 - Vërtetim datë 21.06.2023, nga DRSSH Tiranë për shtetasen V. Alimadhi, e cila trajtohet me pension pleqërie në masën mujore 29.069 lekë. Bashkëlidhur vërtetimet e të ardhurave për periudhën Janar 1994-Qershor 2015, punësuar pranë Qendrës Shëndetësore Çorovodë/Skrapar. Të ardhurat e realizuara për periudhën 1995 deri Dhjetor 2000 janë 632.000 lekë bruto.
 - Vërtetim nr.191 prot., datë 21.06.2023, nga DRSSH Tiranë për shtetasin B.Alimadhi, i cili trajtohet me pension pleqërie në masën mujore 32.689 lekë. Të ardhurat e realizuara për periudhën 25.10.2013 deri 30.06.2023, janë 3.245.591 lekë bruto. Bashkëlidhur vërtetimet e të ardhurave për periudhën Janar 1994-Maj 2013, punësuar pranë Bashkisë Corovodë. Të ardhurat e realizuara për periudhën 1995, deri Dhjetor 2000, janë 560.000 lekë bruto.
- **Raiffeisen Bank** me shkresën datë 08.02.2023, konfirmon llogarinë e pagës në emër të Silvana Sulaj, në të cilën në datë 23.07.2014, tërheq shumën 5000 euro.
- ISSH, me shkresën nr 8/30 prot datë 10.05.2023, konfirmon se shtetasja R.Sulaj, nga muaji Qershor 1992, përfiton të ardhurat nga pensioni i pleqërisë, me masë mujore 11.726 lekë. Për periudhën 1963-1990, konfirmohet punësimi në Kooperativën Bujqësore Kuc, Vlorë.

Trupa e vlerësimit duke konsideruar bindëse shpjegimet e subjektit, deklarin, dokumentacionin e paraqitur, raportin e ILDKPKI, si dhe në korrespondencën e administruar, në mënyrë të përmbledhur konstatoi se:

Apartamenti në Tiranë, me sipërfaqe 62 m², është përfituar nga subjekti deklarues më kontratë shitblerje në vitin 2001, me burim pjesërisht hua në vlerën 2.000.000 lekë dhe kursime të tij familjare përfshirë këtu shumat e dhuruara nga vëllai, prindërit, dhe prindërit e bashkëshortes në vlerat: 100.000 prindërit, 50.000 vëllai, dhe 50.000 prindërit e bashkëshortes (referuar gjithashtu edhe sqarimeve që subjekti ka dhënë pranë ILDKPKI, të pasqyruara në procesverbalin e datës 14.07.2023, pyetja nr 1, si dhe në emailin e datës 18.10.2023, pranë relatorit të cështjes), si dhe të ardhura nga paga e tij dhe bashkëshortes.

Si përfundim, Trupa e Vlerësimit, nga hetimi administrativ, duke verifikuar përputhshmërinë e deklarimeve të subjektit me dokumentacionin e administruar, si dhe duke analizuar ligjshmërinë dhe mjaftueshmërinë nga ana financiare konkludoi se:

✓ Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar nga hetimi

✓ Personat e tjerë të lidhur me subjektin e vlerësimit kanë patur të ardhura të ligjshme, të mjaftueshme për ndërtimin e astetit.

2. Shitur Apartament me sip.62 m², me nr. pasurie *, Zk.***,Vol.****. Subjekti ka deklaruar se ka shitur apartament me sip.62m², me kontratën e shitblerjes datë 06.05.2003 në vlerën 3.000.000 lekë.**

- Shlyer jashtë zyrës noteriale.
- Me deklaratën noteriale të paraqitur nga subjekti, nënshkruar nga pala blerëse V.P. dhe I.P. të cilët deklarojnë me përgjegjesi të plotë se i kanë kërkuar verbalisht shitësit të linte edhe orenditë e apartamentit, dhe çmimi përfundimtar ka qënë 36.500 usd.

Subjekti ka paraqitur dokumentacion provues si më poshtë:

- Mandat transfertë Bankare datë 28.04.2003 në Bank of America, E.G dhe S.G me vendbanim në Kansas City, transferojnë në favor të palës blerëse shumën 36.500 usd.
- Mandat depozitimi dt.07.05.2003 të shumës 36.500 usd, nga Edmond Sulaj pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë, depozitim cash.
- Kontratë depozitë Bankare datë 07.05.2003, nënshkruar nga Edmond Sulaj pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë. Vlera 36.500 usd afat maturimi 30 ditë.
- Deklaratë noteriale datë 02.03.2023, në të cilën palët deklaruese konfirmojnë çmimin përfundimtar të shitjes së apartamentit së bashku me orenditë e brendshme në shumën 36.500 euro. Çmimi i shitjes në kontratën datë 06.05.2003 është 3.000.000 lekë. Blerësit kanë kërkuar të blejnë veçmas apartamentit edhe mobilimin ekzistues të tij, kundrejt një tarife shtesë në shumën totale 36.500 euro, shumë e cila vërtetohet nga mandat pagesat bashkëlidhur deklaratës.

Hetimi administrativ

- **ASHK, Drejtoria Vendore Tirana Jug** konfirmon se, nuk figuron praktikë në emër të Edmond Sulaj dhe personave të lidhur me të.
- **INTESA SAN PAOLO Bank** me shkresën nr. 8/4 prot., datë 11.05.2023, konfirmon se shtetasi Edmond Sulaj ka patur llogari pranë kësaj Banke, në të cilën evidentohen transaksionet datë. 09.07.2003, ku është kredituar interesi i depozitës usd me vlerë 36.551 usd, si dhe në datë 07.05.2003, depozitimi i vlerës 36.500 usd.

✓ *Konstatohet se deklarimi bazohet në dokumentacionin e dorëzuar.*

3.Pasuria nr.2. Apartamenti me nr.***,ZK. ***, Rr.**** P.* ap.**, sip.96.3 m2, përfituar me kontratë më datë 15.07.2003 .

Burimi i krijimit:Nga shitja e apartamentit të mëparshëm.

Vlera 4.000.000 lekë,

Pjesa takuese: 50%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje nr.***, rep., nr. *** kol., datë 15.07.2003, me objekt apartamenti me nr.*** ZK. ***, sip.96.3 m2, me vlerë 4.000.000 lekë, shlyer pas nënshkrimit të kontratës, jashtë zyrës noteriale.

- Subjekti deklaron se burimi i krijimit të të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti ka shërbyer shuma prej **36.500 USD**, nga shitja e apartamentit të mëparshëm.

Hetimi administrativ

Nga verifikimi i INTESA SAN PAOLO Bank, nëpërmjet statement Bankar rezulton të jetë tërhequr shuma e sipërpërmendur nga ana e subjektit Edmond Sulaj më datë 09.07.2003. Në procesverbalin e datës 14.07.2023, pranë ILDKPKI subjekti ka deklaruar shumën prej 200.000 lekë, për mobilim të pjesshëm të këtij apartamenti, për të cilën nuk disponon dokumentacion.

Më datë 15.07.2003, 1 usd është këmbyer me 121.77 lekë, në total **4.442.050 lekë**.

- ✓ ***Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga sa deklaroi subjekti, trupa i konsideroi shpjegimet e tij bindëse dhe të mjaftueshme për të shpjeguar të dhënat që rezultuan lidhur me asetin***

Shitur apartament sip.96.3 m², sipas kontratës nr.rep., *** kol., datë 09.01.2012 cmimi i shitjes, 115.000 euro.**

- Subjekti ka deklaruar se vlera 115.000 euro është likuajduar nga blerësi me dy këste **30.000 euro cash** në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe pjesa tjetër **85.000 euro**, në llogarinë Bankare të bashkëshortes dt.07.02.2012. Zotëron 50%.

Dokumentacioni i paraqitur bashkëlidhur deklaratës

- Kartelë e pasurisë së paluajtshme nr. 6/209 e cila përmban tabelën përlllogaritëse të tatimit mbi pasurinë e rivlerësuar.
- Mandati Bankar i pagesës së tatimit.
- Raport vlerësimi nga inxhinieri i licensuar.

Hetimi administrativ

- Rezulton se pasuria e sipërpërmendur është blerë nga ana e subjektit me kontratën nr.***, rep., nr.*** kol., në shumën **4.000.000 lekë**.
- Më datë 12.12.2011, subjekti nëpërmjet vlerësuesit të pasurive të paluajtshme Ing.R.T. me nr. liçence ***, ka bërë të mundur rivlerësimin e apartamentit me metodën e krahasimit dhe vlera e tregut të lirë ka rezultuar **15.800.000 lekë**.
- Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur rezulton se, Edmond Sulaj ka aplikuar pranë ZVRPP (sot ASHK) për rivlerësimin e pasurisë në emër të tij dhe bashkëshortes dhe shuma e rivlerësimit, përlllogaritur nga ZVRPP rezulton të jetë **10.111.500 lekë**. Referuar legjislacionit të kohës pagesa e tatimit është përlllogaritur **61.110 lekë**, shumë e shlyer nga subjekti me të ardhurat nga paga e tij dhe bashkëshortes, vërtetuar nga mandat pagesa e dorëzuar.
- Pagesa e shitjes është bërë jashtë zyrës noteriale dhe e ndarë në dy këste prej 30.000 euro cash, për të cilat nuk disponohet mandat pagesë dhe 85.000 euro, të cilat janë transferuar në llogarinë e bashkëshortes pranë Raiffeisen Bank , transaksion i kryer nga blerësi N.Q.
- Me shkresën nr.12/15, datë 28.09.2023 drejtuar, Raiffeisen Bank është kërkuar të na vihen në dispozicion pasqyrat e nxjerrjes së llogarisë rrjedhëse; depozitë me/pa afat, në monedhën euro dhe lek për personin e lidhur S.Sulaj, me NRP *****, ID nr.*****, datëlindje 29.06.1976, për periudhën 01.01.2012 - 31.12.2012 .

- Raiffeisen Bank me shkresën nr.***, prot. datë 04.10.2023, ka vënë në dispozicion informacionin e kërkuar ku provohet se në datë 07.02.2012, z.N.Q ka depozituar në favor të znj.S.Sulaj shumën 85.000 euro ,“Kalim për blerje apartamenti sipas kontratës dt.07.01.2012, nr.*** rep nr.*** kol.
 - Në emailin e datës 18.10.2023 subjekti i pyetur nga relatori i çështjes në lidhje me pagesën e tatimit mbi fitimin për pasurinë nr. ***, ZK. ***, i shitur me kontratën nr. ***, rep., dhe *** kol, datë 09.01.2012, në shumën 115,000 euro, ka dhënë shpjegime me email dhe me shkrim, ku ka sqaruar se pagesa e tatimit ka kaluar në dy faza brenda te njëjtit proces. Apartamenti i blerë 4.000.000 lekë është shitur 115.000 euro. Për këtë apartament është bërë vlerësimi mbi bazën e çmimit te references për zonen ku ndodhej apartamenti, ku vlera e rivlerësuar sipas cmimit te references është nxjerrë nga ASHK 10,111,500 lekë. Për vlerën prej 6,111,500 lekë, që përfaqëson diferencën midis vlerës 10,111,500 lekë (vlerë e rivlerësuar nga ASHK sipas cmimit te referencës) - 4,000,000 lekë (vlerë e blerjes së apartamentit), nga ana e ish ZRVPP është përlllogaritur vlera e tatimit përkatës në shumën prej 61,115 lekë, (pasqyruar në formularin e përlllogaritjes nga ana e ASHK.)
 - Për këtë vlerë të tatimit të identifikuar nga ana e ZRVPP, është kryer pagesa nga ana e subjektit sipas mandatit Bankar të lëshuar nga Bankes Credins datë 22.11.2011, sipas te cilit në favor të "llogaria e buxhetit, të ardhurat",Tiranë, llog: *****(llogaria e ish ZRVPP), është paguar vlera prej 61,115 lekë.
 - Së dyti, nga ana e ASHK, është proceduar me fazën e dytë dhe konkretisht me llogaritjen e vlerës së tatimit sa i takon vlerës së rivlerësimit të kësaj pasurie referuar vlerës së nxjerrë nga eksperti i fushës, sipas aktit të ekspertimit i cili ndodhet bashkëlidhur dokumentacioneve provuese të dorëzuara. Sipas vlerësuesit të pasurisë, duke ju referuar cmimit të tregut dhe trendit të rritjes së çmimeve pasuria është vlerësuar në shumën 15,800,000 lekë. Për vlerën prej 5,688.500 lekë që përfaqëson diferencën midis vlerës 15,800,000 lekë (Vlerë e apartamentit sipas rivlerësimit të pasurisë kryer nga eksperti) - 10,111,500 lekë (vlera e apartamentit sipas çmimit të referencës), nga ana e ish ZRVPP, është përlllogaritur vlera e tatimit përkatës prej 56,889 lekë.
 - Për këtë vlerë të tatimit te identifikuar nga ana ZRVPP, është kryer pagesa sipas mandatit Bankar të Banka Credins datë 12.12.2011 sipas të cilit në favor të "llogaria e buxhetit, të ardhurat", 01101 Tiranë, llog:***** (llogaria e ish ZRVPP), vlera prej 56,885 lekë (tatimi) plus 150 lekë (komision) në total =57,035 lekë.
 - Sa më sipër, subjekti deklaroi se ka proceduar me kryerjen e pagesës në përputhje me ligjin sipas vlerave të përlllogaritura nga ana e organit administrativ, ish ZRVPP Tiranë. Vlera totale e tatimit të paguar është 61,115 lekë+56,885 lekë=118,000 lekë (përlllogaritur nga ish ZRVPP, Tiranë).
- Trupa ka marrë në konsideratë sqarimet e subjektit, i cili ka patur barrën e provës, ka administruar aktet që provojnë faktet ndër të cilat vërtetim nga Raiffeisen Bank mbi kalimin e shumës 85.000 euro, kthim përgjigje nga Raiffeisen Bank në lidhje me nxjerrjen e llogarisë së znj.Silvana Sulaj, ku provohet kalimi i shumës nëpërmjet sistemit Bankar; dy mandat pagesat e sipërpërmendura, aktin e ekspertimit, si dhe formularin e përlllogaritjes së tatimit mbi fitimin për pasurinë në fjalë dhe ka arritur në konkluzionin se:

✓ **Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga sa deklaroi subjekti, trupa i konsideroi shpjegimet e tij bindëse dhe të mjaftueshme për të shpjeguar të dhënat që rezultuan lidhur me asetin dhe konkludoi se përputhet deklarimi me shpjegimet e dhëna nga subjekti.**

3.Pasuria nr.3 Apartament me nr. pasurie *****, ZK. ***, me sip.totalë 98 m², përfituar sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr.*** kol., datë 10.02.2012.

Vlera :15.453.760 lekë, pjesë takuese 50%.

Burimi: Kursime familjare dhe të ardhurat e shitjes së pasurisë së mëparshme.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë nr.***, rep., nr.*** kol., datë 10.02.2012 për shitjen e një apartamenti me nr. pasurie ****, ZK 8380 me sip.totalë 98 m2 me palë shitëse E. P dhe M. P dhe palë blerëse Edmond Sulaj dhe Silvana Sulaj.
- Sipas kartelës së pasurisë , kjo pasuri është rivlerësuar në vlerën totale 15.453.760 lekë, shumë e likujduar totalisht sipas deklaramit të palëve.
- Raiffeisen Bank konfirmon me shkresën nr.8/2,prot., datë 08.02.2023 konfirmon llogarinë e pagës në emër të Silvana Sulaj, në të cilën me 07.02.2012 është kredituar nga N.Q. shuma 85.000 euro dhe më datë 8.2.2012 ka tërhequr shumën cash 80.000 euro.
- ASHK nuk konfirmon pasuri të paluajtshme në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.
- Në procesverbalin e datës 14.07.2023 pranë ILDKPKI, subjekti është pyetur nga ana e inspektorit në lidhje me mënyrën e likujdimit të këtij apartamenti dhe shumën e shpenzuar për mobilimin e tij. Subjekti ka sqaruar se likujdimi është bërë cash duke qënë se shitësja E.P. jetonte jashtë kufirit, dhe përfaqësuesja e saj E.B. ka kërkuar të nënshkruajë kontratën vetëm pasi të bëhej pagesa totale. Shuma i është dorëzuar përfaqësueses e cila e ka derdhur në llogarinë e shitëses pranë Credins Bank.
- **Bazuar në deklaramin e subjektit dhe shkresat e administruara rezulton se kjo pasuri është në zotërim 100%, në emër të subjektit dhe bashkëshortes, blerë në vitin 2012 me vlerë 15.453.760 lekë me burim nga të ardhurat e shitjes së apartamentit të mëparshëm në vlerën 110.000 euro, konvertuar në 15.317.500 lekë, referuar kursit të këmbimit 1 euro =139.25 lekë dhe diferenca 136.000 lekë, më të ardhura nga kursimet familjare.**
- ✓ **Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga sa deklaroi subjekti, trupa i konsideroi shpjegimet e tij bindëse dhe të mjaftueshme për të shpjeguar të dhënat që rezultuan lidhur me asetin dhe konkludoi se përputhet deklarimi me shpjegimet e dhëna nga subjekti.**

PASURI TE LUAJTSHME

4.Automjet i llojit Daimler Chrysler tipi 190, sipas kontratës nr.935 **, nr.** kol.,datë 22.04.2004.

- **Burimi i krijimit** të ardhura familjare
- **Vlera** 250.000 lekë. Zoëron 100%

5.Shitur automjeti me kontratën e shitblerjes nr.*, rep., nr**, kol, datë 30.05.2005**

- **Vlera** 250.000 lekë.
- Arkëtuar në dorë blerësit.

→ Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje ** rep., nr.** kol.datë 22.04.2004.
- Kontratë shitblerje nr.*** rep., nr.*** kol., datë 30.05.2005

→ DPSHTRR me anë të postës elektronike të datës 27.06.2023, konfirmon dosjen e automjetit, me të dy kontratat respektive të sipërpërmendura dhe nuk konfirmon automjetin në pronësi të subjektit.

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.**

6. Automjet Fiat Punto, me targë TR.**** Vlera 0. Zotëron 100%. Dhuruar nga bashkëshortja me kontratë dhurimi nr.*** rep.,nr.*** kol., datë 29.06.2010 shitur më pas sipas kontratës së shitblerjes me nr. *** rep.nr *** kol. datë 20.02.2012

Bashkëlidhur deklaratës :

- Kontratë dhurimi nr.*** rep.,nr.*** kol., datë 29.06.2010.
- Kontratë shitblerje mjeti nr.*** rep, nr.*** kol datë 20.02.2012 nënshkruar mes palës shitëse Edmond Sulaj dhe palës blerëse B.Z me çmim shitje 200.000 lekë.
- Kontratë shitblerje automjeti mes S. Sulaj, blerëse dhe E.LL, shitëse me vlerë 400.000 lekë shlyer jashtë zyrës noteriale.
- DPSHTRR nuk konfirmon automjet në pronësi të E.Sulaj, bashkëlidhur praktika.
- Konstatohet automjeti i blerë nga bashkëshortja në 2006, dhuruar subjektit më 2010 i cili e ka shitur në 2012.

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.**

7. Llogari page në Raiffeisen Bank me gjendje në datë 03.03.2023 në vlerën 231.767 lekë.

→ Raiffeisen Bank me shkresën nr 8/2 konfirmon se në emër të Edmond Sulaj, rezulton një llogari page e çelur më datë 03.06.2019 dhe në gjendje dt 07.03.2023 vlerën 221.767 lekë. Më datë 07.03.2023 është tërhequr shuma cash prej 10.000 lekë.

✓ **Ndryshimi i gjendjes se deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga Banka ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Të ardhura të dhuruara nga familjarët për blerjen e apartamentit në vitin 2001 në shumën 250.000 lekë.
- Të ardhura nga paga neto si oficer policie, që nga data 01.10.1997 deri më 3.3.2003 në policinë e shtetit në shumën 39.437 lekë.
- Të ardhura nga paga neto si oficer policie Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë nga data 16.02.1998-19.04.2004, në shumën 2.301.194 lekë.
- Të ardhura nga paga neto si oficer policie në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier nga data 20.04.2004 -15.02.2005, në shumën 398.766 lekë.
- Të ardhura nga paga neto si oficer i policisë në Komisariatin e Policisë Mirditë, periudha 16.02.2005-27.05.2005 në shumën 159.935 lekë.
- Të ardhura neto nga paga si oficer policie ne DVP Tiranë në periudhën 27.05.2005-31.12.2005 në shumën 345.427 lekë.

- Të ardhura nga paga neto për vitin 2006, sipas nxjerrjes së llogarisë së Raiffeisen Bank në shumën 646.288 lekë.
- Të ardhura nga paga neto për vitin 2007, sipas nxjerrjes së llogarisë së Raiffeisen Bank në shumën 608.347 lekë.
- Të ardhura nga paga neto për vitin 2008, sipas nxjerrjes së llogarisë së Raiffeisen Bank në shumën 595.937 lekë.
- Të ardhura nga paga neto për vitin 2009, sipas nxjerrjes së llogarisë së Raiffeisen Bank në shumën 619.818 lekë
- Të ardhura nga paga neto për vitin 2010, sipas nxjerrjes së llogarisë së Raiffeisen Bank në shumën 699.791 lekë.
- Të ardhura nga paga neto për vitin 2011, sipas nxjerrjes së llogarisë së Raiffeisen Bank në shumën 766.610 lekë.
- Të ardhura nga paga neto për vitin 2012, sipas nxjerrjes së llogarisë së Tirana Bank në shumën 768.545 lekë
- Të ardhura nga paga neto për vitin 2013, sipas nxjerrjes së llogarisë së Tirana Bank në shumën 876.993 lekë.
- Të ardhura nga paga neto për vitin 2014, sipas nxjerrjes së llogarisë së Tirana Bank në shumën 1.136.379 lekë
- Të ardhura nga paga neto për vitin 2015, sipas nxjerrjes së llogarisë së Tirana Bank në shumën 995.773 lekë.
- Të ardhura nga paga neto për vitin 2016, sipas nxjerrjes së llogarisë së Tirana Bank në shumën 982.514 lekë.
- Të ardhura nga paga neto për vitin 2017, sipas nxjerrjes së llogarisë së Tirana Bank në shumën 1.379.979 lekë.
- Të ardhura nga paga neto për vitin 2018, sipas nxjerrjes së llogarisë së Tirana Bank në shumën 1.202.818 lekë.
- Të ardhura nga paga neto për vitin 2019, sipas nxjerrjes së llogarisë së Tirana Bank në shumën 1.480.261 lekë.
- Të ardhura nga paga neto për vitin 2020, sipas nxjerrjes së llogarisë së Raiffeisen Bank në shumën 1.379.503 lekë.
- Të ardhura nga paga neto për vitin 2021, sipas nxjerrjes së llogarisë së Raiffeisen Bank në shumën 2.250.081 lekë.
- Të ardhura nga paga neto për vitin 2022, sipas nxjerrjes së llogarisë së Raiffeisen Bank në shumën 1.675.294 lekë.
- Të ardhura nga paga neto për vitin Janar 2023- 03.03.2023 sipas nxjerrjes së llogarisë së Raiffeisen Bank të ardhurat janë 495.275 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Akti i marrjes së tokës në pronësi, sipas të cilës i jepet shtetasit R.S. gjithsej 8.050 m2, tokë bujqësore.
- Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare neto të subjektit i cili për periudhën 01.10.1997-15.02.1998 ka realizuar të ardhura në vlerën totale prej 39.473 lekë.
- Shkresë kthim përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, DVP Tiranë për të ardhurat e realizuara nga shtetasi Edmond Reis Sulaj për periudhën 16.02.1998-20.04.2004, në

total neto rreth 2.326.000 lekë, vlerë e cila përmban dhe orët suplementare, shpërblime, leje vjetore si dhe taksën e solidaritetit.

- Shkresë kthim përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, DVP Tiranë për të ardhurat e realizuara nga shtetasi Edmond Reis Sulaj për periudhën 20.04.2004-15.02.2005 në total neto rreth 398.766 lekë.
- Vërtetim mbi bazën e vlerësueshmë dhe pagën neto mesatare të subjektit i cili për periudhën Shkurt - Maj 2005 ka realizuar të ardhurat totale prej 159.935 lekë.
- Vërtetim nga Raiffeisen Bank dt. 21.2.2023 mbi produktet bankare të subjektit gjatë periudhës 2005-2011 dhe 2019-2022.
- Nxjerrje llogari page e subjektit.
- Raiffeisen Bank konfirmon llogarinë e pagës në emër të subjektit në të cilën janë kredituar paga gjatë periudhës 16.06.2005-02.02.2011 në shumën 3.938.000 lekë dhe nga 05.06.2019-2.3.2023 në shumën totale 6.698.700 lekë. Referuar lëvizjeve të llogarisë rezulton se në datë 16.04.2021 përveç pagës periodike referuese të muajit Mars është transferuar/kredituar shuma 659.714 lekë me përshkrimin paga për të cilën subjekti ka dhënë sqarime dhe ka vënë në dispozicion vërtetimin nr.1711 prot datë 14.06.2023 nga DPPSH për përfitimin e shumës së përfituar, duke sqaruar se këtë shumë e ka përfituar si pjesëmarrës në operacionin Forca e Ligjit.
- Tirana Bank konfirmon se shtetasi Edmond Sulaj ka patur llogari page, në të cilën gjatë periudhës 03.03.2011-3.6.2019 janë kredituar paga ose shpërblime, në shumën totale 8.717.000 lekë.
- ISSH konfirmon të ardhurat e realizuara nga Edmond Sulaj gjatë periudhës Janar 2012 –Shkurt 2014; Qershor 2017-Qershor 2018; Dhjetor 2022-Mars 2023 pranë DPPSH; Mars 2014-Maj 2017 pranë Departamenti për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda/Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale; Qershor 2018-Tetor 2021 pranë Drejtorisë së Antiterrorit; Tetor 2021-Dhjetor 2022 pranë DVP Kukës.
- Më datë 14.07.2023 subjekti është pyetur nga ILDKPKI për të sqaruar të ardhurat e përfituara për shkak të pozicionit (sqaruar më sipër).
- Subjekti deklaroi se, së bashku me bashkëshorten, ka përfituar të ardhura të tjera përveç pagës sic është taksa e solidaritetit si dhe të ardhura për punë jashtë orarit. Sikurse ka referuar edhe në deklaratën e pasurisë të dhënat e siguruara nga DPPSH dhe strukturat e saj të varësisë, sa i takon masën së pagës së marrë nga ai dhe bashkëshortja nuk reflektojnë të dhënat reale të vlerave të përfituara, pasi të ardhurat janë përfituar më listëpagesë të veçantë nga ajo e pagave.
- Në muajin Tetor 1997-Dhjetor 1997 bazuar në urdhërat nr 7/39 datë 16.04.1997 dhe nr. 7448 datë 26.11.1998, si dhe VKM 137 datë 15.03.1997 ka përfituar shpërblim nga taksa e solidaritetit 15.000 lekë në muaj, total 45.000 lekë si dhe Janar 1998-Dhjetor 1998 gjithsej 180.000 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Urdhër i Ministrit të Rendit Publik nr 7/448 datë 26.11.1998 “Për trajtimin me shpërblim të funksioneve organike ushtarake në sistemin e Ministrisë së Rendit Publik”.
- Urdhër i Ministrit të Rendit Publik nr. 35, datë 15.3.1998 “Për disa shtesa dhe ndryshime ne urdhërin 7/448 dt.26.11.1998.
- Urdhër i Ministrit të Brendshëm nr. 7/39,, datë 16.4.1997 “Për shpërblimet e punonjësve”.
- Shkresë nr 7/41 datë 21.04.1997 “Për përcaktimin e koeficientit maksimal të shpërblimit”.
- Urdhër i Ministrit të Brendshëm nr.7/96, datë 13.05.1997 “Për trajtimin me shpërblim të punonjësve të sistemit të MB”.
- Urdhër i Ministrit të Rendit Publik nr. 25, datë 15.02.1999, “Për caktimin e masës së shpërblimit që do të përfitohet nga taksa e solidaritetit”.
- Urdhërat mujore të përcaktimit të masës së shpërblimit që përfitohet nga taksa e solidaritetit.

- CV, për përcaktimin e gradës policore.
- ✓ **Të ardhurat e subjektit nga paga, shpërblimet për periudhën 1997- Mars 2023 konfirmohen në vlerën totale 22.278.000 lekë**
- ✓ **Të ardhurat e deklaruara nga subjekti nga taksa e solidaritetit, që i përkasin periudhës 1997-1998, të pallogaritura në listëpagesat e vërtetimeve të paraqitura, janë në total 225.000 lekë.**

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

Në pasqyrën e shpenzimeve e deklarueshme në deklaratën e Veting subjekti deklaroi shpenzimet për ujë, drita, telefon përgjatë vitit 2022.

Në pasqyrën e shpenzimet të deklarueshme në deklaratën e pasurisë subjekti deklaroi:

- Shpenzime për energji elektrike për vitin 2022, gjithsej 77.364 lekë
- Shpenzime për kontratën UKT, në shumën 30.354 lekë.
- Shpenzime interneti ,në shumën 15.600 lekë.
- Shpenzime për telefon celular, në shumën 2.102 lekë.
- Shpenzime për telefon celular, bashkëshortja në shumën 14.625 lekë
- Shpenzime për telefon celular, Esi Sulaj në shumën 12.355 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës

- Faturat tatimore lëshuar nga UKT, për klientin Edmond Sulaj gjatë periudhës Janar –Dhjetor 2022 në shumën totale 77.360 lekë.
- Dokument përmbledhës i vlerës së faturuar nga UKT, për abonentin Edmond Sulaj gjatë vitit 2022 në vlerën totale 30.160 lekë.
- Dokument nga Vodafone Albania për klientin S.Sulaj Janar-Dhjetor 2022 në vlerën totale 13.350 lekë.
- Dokument nga Vodafone Albania për klientin E.Sulaj (e bija) në vlerën totale 10.455 lekë Janar-Dhjetor 2022.

Hetimi administrativ

- Furnizuesi i Shërbimit Universal me shkresën nr *** prot datë 18.5.2023 konfirmon se Edmond Sulaj figuron abonent për objektin apartament me adresë Bulevardi Zhan Dark 1-14.
- Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Tiranë me shkresën nr.** prot datë 24.05.2023 konfirmon se në emër të Edmond Reis Sulaj figuron kontrata nr.***** për objektin me adresë Bulevardi “Zhan Dark” status aktiv dhe detyrime të shlyera deri në Mars 2023. Gjithashtu figuron edhe një kontratë tjetër me adresë rr.Arkitekt Sinani status aktiv dhe detyrime të palikujduara në shumën 65.361 lekë, për të cilën shprehet se nuk disponon asnjë dokumentacion.
- Në emailin e datës 18.10.2023, subjekti është pyetur nga ana e Relatorit të çështjes në lidhje me këtë kontratë. Subjekti ka patur barrën e provës dhe funksion të saj i ka kërkuar shkresërisht Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Tiranë, informacion të mëtejshëm dhe me shkresën nr. 15711/1 prot datë 31.10.2023 kjo e fundit konfirmon se kjo kontratë nuk i përket subjektit të vlerësimit.
- Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime, Durrës me shkresën nr 8/38 prot datë 29.05.2023 informon se rezulton një kontratë në emër të Silvana Sulaj me nr. ** me adresë Krugë, për të cilën nuk ka asnjë dokumentacion bashkëlidhur.

- Në emailin e datës 18.10.2023, subjekti është pyetur nga ana e Relatorit të çështjes në lidhje me këtë kontratë. Subjekti i ka kërkuar shkresërisht UKD informacion, dhe kjo e fundit me shkresën nr.**** datë 31.10.2023 konfirmon se kjo kontratë nuk i përket zonjës Silvana Sulaj.
- Shoqëritë e tjera të Ujësjellës Kanalizime nuk konfirmojnë kontrata të lidhura në emër të subjektit apo personave të lidhur me të.
- Vodafone Albania me shkresën nr *** prot dt.13.07.2023, konfirmon dokumentacionin ligjor për pajisjen më numër kontakti Edmond Sulaj, Silvana Sulaj dhe Esi Sulaj. Gjithashtu evidentohet vlera e faturimit vjetor të telefonisë fikse në emër të Edmond Sulaj në vlerën 14.083 lekë, S. Sulaj në vlerën 6000 lekë E.Sulaj në vlerën 11.400 lekë.
- One Albania sh.a me shkresën nr.*** prot datë 7.6.2023 konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk rezultojnë të kenë numra të regjistruar pranë kësaj kompanie.
- Albania Satellite Communications shpk, Abisnet sha, Digicom sh.a nuk konfirmojnë kontrata në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.

✓ **Konstatohet se shpenzimet e deklaruara nga subjekti gjatë periudhës Janar 2022-Dhjetor 2022 në emër të tij apo personave të tij të lidhur, kanë qënë në total 152.000 lekë.**

- Për udhëtimet private personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike) duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara – periudha 01.01.2020 — 31.01.2022.
- Shpenzime udhëtime familjare + personale. Shuma 2.022 euro.
- Udhëtime familjare: 14.01.2022 - 16.01.2022, unë, bashkëshortja dhe dy vajzat në Prizren. Udhëtim dhe qëndrim 450 euro. 17.06.2022 - 20.06.2022, bashkëshortja dhe dy vajzat në Barcelonë, Udhëtim dhe qëndrim 990 euro.
- Udhëtime personale:

Udhëtim në Prishtinë dt. 29.05.2021 - 29.05.2021, shpenzuar 50 euro. Bashkëshortja udhëtime pune: në datat 01.05.2022 - 07.05.2022 në Lisbonë, 01.06.2022 - 03.06.2022, në Podgoricë; 21.09.2022 - 24.09.2022, në Bruksel; 23.11.2022 - 25.11.2022, në Bruksel. Shpenzimet janë mbuluar nga pala organizatore/punëdhënësi.

Vajza Esi Sulaj: ka udhëtuar por periudhat 04.12.2021 - 05.12.2021 në Prizren, shpenzime 65 euro, 19.3.2022 - 20.3.2022 ne Budva, shpenzuar 65 euro, 12.7.2022 - 16.7.2022 Lisbonë, shpenzuar gjithsej 450 euro.

Në proces-verbalin e datës 14.07.2023, subjekti paraqiti dokumentacionin përkatës nga sistemi TIMS për të dhe familjarët. Deklaroi se për shkak të problemeve që ka patur sistemi, në periudhën kur ka plotësuar deklarimin, ka rakorduar udhëtimet familjare dhe i rezultojnë një udhëtim shtesë, kryer nga vajza e vogël në shtetin italian, për arsye shkolle (dhënie provini gjuhë e huaj). Udhëtimi ka patur afat 1 ditë (një natë qëndrimi në hotel dhe rruga vajtje-ardhje dy ditë). Paraqiti dokumentacionin e biletës së udhëtimit dhe qëndrimit në hotel. Në total shuma e shpenzuar 118 euro e cila përmban vlerën e udhëtimit 91 euro dhe dhomën e hotelit, (108 euro dhomë për 4 studentë).

Hetimi administrativ:

Trupa e vlerësimit ka bërë verifikimet përkatëse në sistemet TIMS, E-gjoha etj në lidhje me hyrje daljet e subjektit dhe personave të lidhur me të dhe ka arritur në konkluzionin se:

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar sa i përket hyrje-daljeve nga RSH gjatë periudhës 2020 — 2022, të subjektit dhe personave të lidhur me të. Shpenzimet e deklaruara për udhëtimet private, personale dhe të personave të lidhur gjatë periudhës së sipërcituar, rezultojnë në total rreth 2.190 euro, konvertuar rreth 250.000 lekë.**

- Për arsimin e fëmijëve, madhore apo të mitur, dhe të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve, sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit të vlerësimit - Periudha nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë subjekti ka deklaruar:
 - Shpenzime për shkollimin e bashshortes në universitet shtetëror, në vitet 2009 - 2011 dhe 2020. Shuma **374.000 lekë**.
 - Shpenzime për shkollimin e vajzës Esi Sulaj, në universitetin privat, në vitet 2018 - 2022. Shuma **8.300 euro**.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim nr. prot. ****, date 24.2.2023, nga Epoka University për Esi Sulaj, e cila për periudhën 2018 - 2022 ka kryer pagesa në vlerën totale prej 8.300 euro.
- Intesa San Paolo Bank, konfirmon se transaksione të kryera në bankë nga E. Sulaj; në dt 07.03.2019, në vlerën 200 euro me përshkrim "***** cash deposit në vlerën 900 euro, pagesë për Universitetin****", dt.03.03.2020 cash deposit në vlerën 900 euro.

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.**

Shpenzimet e deklaruara për arsimimin e personave të lidhur (b/shortes dhe vajzës) gjatë periudhës deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë rezultojnë në total 374.000 lekë + 8.300 euro, konvertuar rreth 1.323.000 lekë.

- ❖ Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti ka deklaruar adresën e plotë ku është regjistruar në Gjendjen Civile, si dhe adresën e plotë ku banon: "Njësia Administrative nr. 10, Bulevardin. "Gjergj Fishta" 6/3/11/, Tiranë".

Hetimi administrativ

Në proces-verbalin e datës 14.7.2023, subjekti ka sqaruar se në vitin 2012, kur ka blerë apartamentin aktual, adresa ishte Bulevardi "Zhan Dark", aktualisht po kjo adresë quhet Bulevardi "Gjergj Fishta" e pasqyruar dhe në adresën e tij në gjendjen civile, Njësia Administrative nr. 10, Tiranë. Sqaroi se për momentin vajza e tij në moshë madhore Esi Sulaj, banon në të njëjtën adresë me të. Në emailin e datës 01.12.2023 subjektit i është kërkuar sqarim në lidhje me ndryshimin e adresës, pasqyrimin e ndryshimit, kopje të certifikatës së pronësisë së apartamentit.

Më datë 04.12.2023 subjekti i vlerësimit ka dhënë sqarimet përkatëse në lidhje me pyetjet që i janë bërë duke vënë në dispozicion:

- a. Kopje të fotografisë së dokumentit të vendosur nga Bashkia Tiranë në derën e apartamentit ku citohet adresa e re e banimit;
- b. Kopje print screen të imazhit që shfaqet në adresarin për Qytetin e Tiranës sa i takon adresës së ndërtesës ku banon;
- c. Kopje kërkesë drejtuar Njesisë Administrative nr.10 Tiranë, datë 01.12.2023.
- d. Shkresë ***** e Njesisë Administrative nr. 10, Tiranë.

- e. Certifikatë e pasurisë për apartamentinin, pasuria me nr. **** volumi 33 faqe 20, zona kadastrale *** të referuar me adresë Rr “Bulevardi Zhan D’Ark, lloji i pasurisë Apartament, sipërfaqja totale 98 m2.
 - f. Të dhëna nga llogaria bankare lëshuar nga Raiffeisen Bank në emër të bashkëshortes Silvana Sulaj.
 - g. Certifikatë personale dhe familjare me adresë banimi sipas kthim përgjigjes së njësisë Administrative nr.10, Tiranë.
- ✓ **Rezulton se adresa e deklaruar nga subjekti i referohet apartamentit të deklaruar në pronësi (trajtuar më lart).**

DEKLARIMI I BASHKËSHORTES, SILVANA SULAJ

1. Apartament me sip. 62 m2, regjistri hipotekor * ZK. ***, sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., date 25.01.2001. Vlera 3.000.000 lekë.**

Burim krijimi: Kursime nga të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortit nga momenti i fillimit të detyrës deri në momentin e blerjes së apartamentit, si dhe marrë hua. Zotërimi 50%.

✓ **Trajtuar më lart.**

2. Shitur apartament me sip. 62 m2, regjistri hipotekor *, ZK ***, sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., date 06.05.2003. Përveç cmimit të shitjes së apartamentit, është shitur edhe mobilimi. Vlera gjithsej e arkëtuar nga shitësi është 36.500 Usd, të cilën e kam depozituar në Bankën Amerikane (sot Intesa Sanpaolo Bank). Vlera 3.000.000 lekë. Zotëron 50%.**

✓ **Trajtuar më lart.**

3. Apartament me nr. pasurie * ZK ***, i ndodhur në Rr. "****", P.* Ap. * me sip. 96.3 m2, përfituar sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.07.2003. Vlerë 4.000.000 lekë, likuiduar me nënshkrimin e kontratës.**

Burimi i krijimit: Të ardhura nga shitja e pasurisë së paluajtshme dhe mobilimit, si dhe të ardhura të tjera familjare. Zotëron 50%.

✓ **Trajtuar me lart.**

4. Apartament me nr. pasurie * ZK ***, i ndodhur ne Rr. "****", P.*, Ap. **, me sip. 96.3 m2, sipas kontratës nr.** rep., nr. 30 kol., datë 09.01.2012. Vlera 115.000 euro, është likuiduar nga blerësi në dy keste: 30.000 euro cash në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe pjesa tjetër prej 85.000 euro është likuiduar në llogarinë Bankare të bashkëshortes më dt. 07.02.2012. Zotëron 50%.**

✓ **Trajtuar më lart.**

Automjet tip Autobianchi Y10, sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë së luajtshme nr. *** rep., *** kol., datë 30.6.2005. Vlera 250.000 lekë. Të ardhura nga paga ime dhe bashkëshortit deri në momentin e blerjes së automjetit.

Shitur automjeti, tip Autobianchi Y10, me targë ***, sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. **** rep. nr. *** kol. datë 28.8.2006. Vlera 250.000 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

1.Kontratë shitblerje pasurie të luajtshme, datë 30.06.2005, palë shitëse A.N dhe palë blerëse Silvana Sulaj të një automjeti tip Autobianchi Fiat Y10. Çmimi i shitjes 250.000 lekë, është likuiduar mes palëve.

2.Kontratë shitje pasuri e luajtshme nr. **** rep., nr. *** kol., datë 28.8.2006, palë shitëse Silvana Sulaj dhe palë blerëse I. K, të automjetit tip Autobianchi Fiat Y10. Çmimi i shitjes 250.000 lekë, është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

Hetimi administrativ

- DPSHTRR, me shkresën nr. 8/27 prot., datë 11.05.2023, nuk konfirmon automjet në pronësi të shtetases Silvana Sulaj.
- DPSHTRR, me postën elektronike date 27.06.2023, konfirmon dosjen e automjetit me targë TR9921K.

Bashkëlidhur deklaratës:

1.Kontratë shitblerje pasurie të luajtshme, date 30.6.2005, palë shitëse A.N dhe pale blerëse Silvana Sulaj, të një automjeti tip Autobianchi Fiat V10. Cmimi i shitjes 250.000 lekë, është likuiduar mes palëve.

2.Kontratë shitje pasuri e luajtshme nr. ** rep., nr. ** kol., datë 28.08.2006, palë shitëse Silvana Sulaj dhe palë blerëse I.K, të automjetit tip Autobianchi Fiat Y10. Cmimi i shitjes 250.000 lekë, është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

- ✓ **Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar nga hetimi**
- ✓ **Personi i lidhur me subjektin e vlerësimit ka patur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e mjetit në vitin 2006.**

5.Automjeti tip Fiat Punto, me targë ***, sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr.*** kol., datë 13.09.2006. Vlera 400.000 lekë. Të ardhura nga shitja e automjetit te mëparshëm, si dhe kursime nga paga ime dhe e bashkëshortit deri në momentin e blerjes së automjetit.

6.Dhuruar automjeti me kontratë dhurimi nr. *** rep., nr.*** kol., datë 29.06.2010, nëpërmjet të cilës i kam dhuruar bashkëshortit automjetin Fiat Punto, me targë ****. Vlera 0 lekë. Zotëron 100%.

- ✓ **Trajtuar më lart.**

7.Automjet Peugeot, sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë së luajtshme nr. ***rep., nr. *** kol., datë _02.2010., Vlerë 3.000 euro. Zotëron 100%. Të ardhura nga paga ime dhe e bashkëshortit, deri në momentin e blerjes së automjetit.

Bashkëlidhur deklarates:

- Kontrate shitblerje pasurie të luajtshme, nr.*** rep., nr. *** kol., date _02.2010, palë shitëse A. T. dhe palë blerëse Silvana Sulaj, të automjetit tip Peugeot. Çmimi i shitjes 3.000 euro, është likuiduar mes palëve.

Hetimi administrativ:

DPSHTRR konfirmon blerjen e automjetit Peugeot nga Silvana Sulaj, sipas kontrates nr. *** rep., nr.*** kol., datë 24.2.2010, vlerë 3.000 euro.

- ✓ **Konstatohet; Automjeti tip Peugeot është përfituar me kontratë blerje të v. 2010.**
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.**

8.Llogari në Raiffeisen Bank në monedhen usd. Gjendje në datë 23.02.2023, vlera 121.9 usd. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim mbi produktet bankare të klientit Silvana Sulaj. Evidentohet balanca e llogarisë USD, në fillim të vitit 2023, në vlerën 121.9 usd.
- Nxjerrje llogarie në emër të Silvana Sulaj, pranë Raiffeisen Bank, për periudhën 01.03.2023 - 08.03.2023. Gjendje në dt. 8.3.2023, në vlerën 0.86 usd.
- Të dhënat e llogarisë USD, në emër të Silvana Sulaj, pranë Raiffeisen Bank.

Hetimi administrativ:

- Raiffeisen Bank , konfirmon llogarinë rrjedhëse (USD), në emër të Silvana Sulaj dhe gjendjen në dt. 09.03.2023, në vlerën 0.86 Usd. Në dt. 08.03.2023 është tërhequr cash shuma 118 usd.
- Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga Banka, ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme.
- Depozitë në Raiffeisen Bank në monedhën lekë. Gjendje në datë 23.2.2023 vlera 2.073.838 leke. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

1.Vërtetim mbi produktet bankare të klientit Silvana Sulaj. Evidentohet çelja e llogarisë në vitin 2008, si dhe balanca e saj në fillim të vitit 2023, në vlerën 2.073.838 lekë. Referuar vërtetimit, evidentohen gjithashtu, shtesat dhe pakësimet e llogarisë për periudhën 2008 - 2023.

2.Të dhënat e llogarisë ALL, në emër të Silvana Sulaj pranë Raiffeisen Bank.

Hetimi administrativ:

- Raiffeisen Bank , konfirmon llogarinë në emër të Silvana Sulaj dhe gjendjen në dt. 09.03.2023, në vlerën 2.073.567 lekë. Evidentohet se kjo llogari është krijuar në dt. 4.12.2008 dhe është kredituar periodikisht me transfertat të b/shortes së subjektit, nga llogaria e pagës, kreditime nga pagesa pjesëmarrje në trajnime, depozitime cash, si dhe kreditime nga llogaria e b/shortit, i cili në dt. 26.4.2021, transferon shumën 650.000 leke, si dhe në dt. 2.12.2022, shumën 400.000 lekë.
- Gjithashtu, Banka konfirmon llogarinë e pagës në emër të Edmond Sulaj, në të cilën rezulton se në datë 16.4.2021, përveç pagës periodike referuese të muajit Mars, është përfituar edhe shuma 659.714 lekë me përshkrimin "paga". (Trajtuar tek të ardhurat)
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank.**

8.Llogari page në Tirana Bank: Vlera 79.334 lekë. Të ardhura nga paga ime, shuma deri në dt. 03.03.2023. Zotëron 100%.

- Tirana Bank konfirmon llogari page në emër të Silvana Sulaj dhe gjendjen në dt. 09.03.2023, në vlerën 31.396 lekë.

→ **Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka, ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme.**

9.Llogari kursimi në Tirana Bank. Vlera 300.266 lekë. Kursime nga paga ime, shuma deri në dt. 03.03.2023. Zotëron 100%.

→ Tirana Bank konfirmon llogari kursimi në emër të Silvana Sulaj dhe gjendjen në dt. 09.03.2023, në vlerën 365.310 lekë.

→ **Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga Banka, ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Të ardhura nga paga neto si oficer policie në Drejtorinë Vendore të Policisë Berat për periudhën nga data 01.10.1997 deri në datë 23.3.1999. Shuma e të ardhurave 194.015 lekë.
- Të ardhura nga paga neto si oficer policie në Ministrinë e Brendshme për periudhën 1998-Qershor 2001. Shuma e të ardhurave 638.886 lekë.
- Të ardhura nga paga neto si oficer policie në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për periudhën 1.7.2001 - 30.5.2005. Shuma e të ardhurave 1.716.230 lekë.
- Të ardhura nga paga neto si oficer policie në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për periudhën Maj - Dhjetor 2005, sipas nxjerrjes së llogarisë bankare në Raiffeisen Bank . Shuma e të ardhurave 420.703 lekë.
- Të ardhura nga paga neto si oficer policie në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vitin 2006, sipas nxjerrjes së llogarisë bankare në Raiffeisen Bank . Shuma e të ardhurave 562.421 lekë.
- Të ardhura nga paga neto si oficer policie në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vitin 2007, sipas nxjerrjes së llogarisë bankare në Raiffeisen Bank. Shuma e të ardhurave 667.554 lekë.
- Të ardhura nga paga neto si oficer policie në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vitin 2008, sipas nxjerrjes së llogarisë bankare në Raiffeisen Bank . Shuma e të ardhurave 797.731 lekë.
- Të ardhura nga paga neto si oficer policie në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vitin 2009, sipas nxjerrjes së llogarisë bankare në Raiffeisen Bank. Shuma e të ardhurave 1.019.308 lekë.
- Të ardhura nga paga neto si oficer policie në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vitin 2010, sipas nxjerrjes së llogarisë Bankare në Raiffeisen Bank . Shuma e të ardhurave 958.599 lekë.
- Të ardhura nga paga neto si oficer policie në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vitin 2011, sipas nxjerrjes së llogarisë bankare në Tirana Bank. Shuma e të ardhurave 998.444 lekë.
- Të ardhura nga paga neto si oficer policie në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vitin 2012, sipas nxjerrjes së llogarisë bankare në Tirana Bank. Shuma e të ardhurave 848.494 lekë
- Të ardhura nga paga neto si oficer policie në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vitin 2013, sipas nxjerrjes së llogarisë Bankare në Tirana Bank. Shuma e të ardhurave 877.703 lekë.

- Të ardhura nga paga neto si oficer policie në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vitin 2014, sipas nxjerrjes së llogarisë bankare në Tirana Bank. Shuma e të ardhurave 952.951 lekë.
- Të ardhura nga paga neto si oficer policie në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vitin 2015, sipas nxjerrjes së llogarisë Bankare në Tirana Bank. Shuma e të ardhurave 1.210.096 lekë.
- Të ardhura nga paga neto si oficer policie në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vitin 2016, sipas nxjerrjes së llogarisë Bankare në Tirana Bank. Shuma e të ardhurave 1.114.149 lekë.
- Të ardhura nga paga neto si oficer policie në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vitin 2017, sipas nxjerrjes së llogarisë bankare në Tirana Bank. Shuma e të ardhurave 1.139.088 lekë.
- Të ardhura nga paga neto si oficer policie në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vitin 2018, sipas nxjerrjes së llogarisë Bankare në Tirana Bank. Shuma e të ardhurave 1.181.890 lekë.
- Të ardhura nga paga neto si oficer policie në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vitin 2019, sipas nxjerrjes së llogarisë Bankare në Tirana Bank. Shuma e të ardhurave 1.132.856 lekë.
- Të ardhura nga paga neto si oficer policie në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vitin 2020, sipas nxjerrjes së llogarisë bankare në Tirana Bank. Shuma e të ardhurave 1.166.960 lekë.
- Të ardhura nga paga neto si oficer policie në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vitin 2021, sipas nxjerrjes së llogarisë Bankare në Tirana Bank. Shuma e të ardhurave 1.241.633 lekë.
- Të ardhura nga paga neto si oficer policie në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vitin 2022, sipas nxjerrjes së llogarisë Bankare në Tirana Bank. Shuma e të ardhurave 1.119.253 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim nga ISSH për bazën e vlerësuar të kontributeve të deklaruara nga shtetasi S.A. Për periudhën Tetor 1997 - Mars 1999, ka përfituar të ardhura neto pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Berat, në total rreth **194.000 leke** (të ardhurat Tetor 1997 - Shkurt 1998, në vlerën **36.055 lekë**).
- Vërtetim nga Ministria e Brendshme për Silvana Sulaj, e cila ka qenë e punësuar gjatë periudhës 16.2.1998 - Qershor 2001 ka përfituar të ardhura neto në total rreth **638.886 lekë** (të ardhurat Shkurt 1998 - Dhjetor 2000, në vlerën **546.797 lekë**).
- Vërtetim nga Ministria e Brendshme nr.1489., datë 13.04.2028, për Silvana Sulaj e cila gjatë periudhës 01.07.2001-Maj 2005, ka përfituar të ardhura neto në total rreth 1.716.230 lekë.
- Nxjerrje llogari page në emër të Silvana Sulaj, pranë Raiffeisen Bank , gjatë periudhës 01.01.2011-31.12.2022

Hetimi administrativ:

- Raiffeisen Bank konfirmon llogarinë e pagës në emër të Silvana Sulaj, në të cilën janë kredituar paga gjatë periudhës 4.5.2005-13.12.2010 në shumën 4.280.000 lekë.

Gjithashtu konfirmohet se Znj.Sulaj ka përfituar të ardhura nga pjesëmarrje në trajnime:

1. Të ardhura (ALL) sipas transfertave Bankare dt. 08.06.2011 vlerë 23.500 lekë; dt 2.7.2012 vlerë 98.487 lekë; dt.27.7.2012 vlerë 19.658 lekë (total 141.600 lekë)
 2. Të ardhura (USD) sipas transfertave bankare nga UNPD, dt 15.10.2009, vlerë 771 USD, nga Unated Nations Developement dt.14.05.2018 vlerë 283.9 USD dhe dt.27.9.2022 vlerën 126.4 USD.
- ISSH konfirmon të ardhurat e realizura nga Silvana Sulaj, gjatë periudhës Dhjetor 2012 - Dhjetor 2013; gusht 2014 – Mars 2023; Qershor 2014 pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Dhjetor 2013 - Qershor 2014 pranë Departamentit për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda.

Në proces-verbalin e datës 14.7.2023, subjekti sqaroi se lidhur me të ardhurat e realizuara nga taksa e solidaritetit e bashkëshortes, Silvana Sulaj, e cila ka qenë në atë periudhë si oficere policie, institucioni nuk ka siguruar asnjë informacion për shpërblimin e taksës së solidaritetit. Në vertetime është pasqyruar vetëm paga neto. Në këtë kuptim, edhe për bashkëshorten, duhet të llogaritet pagesa për taksën e solidaritetit, sipas bazës së mësipërme ligjore.

Sa me sipër për muajin Tetor 1997 - Dhjetor 1997 është trajtuar shpërblim nga taksa e solidaritetit 15.000 lekë/muaj, gjithsej 45.000 lekë. Nga muaji Janar 1998 - Dhjetor 1998 është trajtuar me taksë solidariteti 15,000 lekë në muaj, gjithsej 180.000 lekë. Nga muaji Janar 1999 - Dhjetor 1999 është trajtuar me taksë solidariteti sipas kategorizimit në urdhërat e Ministrit të Brendshëm për funksionin si oficere policie në Ministrinë e Brendshme.

Gjithashtu subjekti sqaroi se të ardhurat e konfirmuara nga Unioni Financiar Tiranë, janë përfituar nga bashkëshortja nga një vizitë studimore në Portugali, aktivitet i zhvilluar nga puna e saj.

Në emailin e datës 18.10.2023 i pyetur nga relatori i trupës në lidhje me transfertën në shumën 672 euro në emër të bashkëshortes, subjekti ka dhënë shpjegimet përkatëse si më poshtë:

“Kjo shumë është disbursuar për llogari të bashkëshortes sime më datë 27.04,2022 nga organizatoret e nje projekti suedez i policimit ne komunitet. Ne këtë kuadër, ky projekt në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, organizoi një ëorkshop mbajtur në Lisbonë, Portugali. Bashkëshortja ime ka marrë pjesë në këtë aktivitet, bazuar në Urdhrin nr.469, datë 26.04.2022, protokolluar me nr.prot.,3050/1, datë 26.04.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, në kuadër të detyrës së saj funksionale si shefe e sektorit për mbrojtjen e të miturve dhe dhunës në familje në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Kjo vlerë prej 672 euro e transferuar për llogari të bashkëshortes, përfaqëson dietat për kompesimin e shpenzimeve gjatë qëndrimit në Lisbonë. Bashkëlidhur Ekstrakt të të dhënave të transfertës dhe kopje te Urdhrit nr.469, datë 26.04.2022, protokolluar me nr.prot., 3050/1, datë 26.04.2022, i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.”

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim nr. 6717 prot., datë 23.6.2023, nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetese, për shtetasen Silvana Sulaj (Alimadhi) dhe të ardhurat e realizuara për periudhën 16 Shkurt - 1 Korrik 2001. Në total 638.886 lekë. Sipas vërtetimit, neto të ardhurat e mësipërme nuk janë përfshirë të ardhurat e përfituara nga taksa e solidaritetit.
 - Curriculum Vitae e Silvana Sulaj, për përcaktimin e nivelit të kategorizimit të gradës policore.
 - Mandatin përkatës nga Moneytrans, vlerë 672 Euro.
- ✓ Të ardhurat e bashkëshortes nga paga, shpërblimet, për periudhën 1997 – Mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 20.041.000 lekë.

- ✓ Të ardhurat e bashkëshortes nga pjesëmarrja ne trajnime, konfirmohen në vlerën 243.000 lekë + 1.181 usd + 672 euro, konvertuar rreth 448.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat e deklaruara nga b/shortja nga taksa e solidaritetit, dhe i përkasin periudhës 1997 - 2000, të pa llogaritura në listëpagesat e vërtetimeve të paraqitura. janë rreth 500.000 lekë/bruto.
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e vënë në dispozicion.**

DETYRIME FINANCIARE

- Kartë krediti pranë Tirana Bank, me vlerë limiti 50.000 lekë. Detyrimi financiar 0 lekë.

Hetimi administrativ

Tirana Bank, me postën elektronike datë 10.7.2023 konfirmon se se shtetasja Silvana Sulaj ka kartë krediti aktive, celur në 11.06.2020 me limit 50.000.00 lekë. Në date 9.3.2023, klientja nuk ka patur detyrim.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e Tirana Bank.**

DEKLARIMI I VAJZËS, ESI SULAJ

1.Llogari Bankare pranë Credins Bank, me gjëndje në datën 27.2.2023, vlerën 134.259 lekë.Zotëron 100%. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga ime pranë “Shaga” shpk.

Bashkëlidhur deklaratës

- Nxjerrje e llogarisë në emër të Esi Sulaj, pranë Credins Bank, gjatë periudhës 09.12.2020 - 27.02.2023. Gjendje në llogari dt. 27.02.2023, në vlerën 134.259 lekë.

Hetimi administrativ

Credins Bank, konfirmon llogari page në emër të Esi Sulaj dhe gjendjen në dt. 9.3.2023, në vlerën 134.129 lekë.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Credins Bank.**

2.Kuotë në shoqërinë “Adesta” shpk., me NUIS ***, Rruga ****, ndërtesa **, hyrja * ap. 2, nr. pasurie ****, ZK ***. Kapitali themeltar 100.000 lekë, pjesëmarrja 10%. Vlera e kapitalit perkatës 10.000 lekë. Burimi i krijimit: Kursime të miat.

Hetimi administrativ

- **QKB** konfirmon se, Esi Sulaj figuron të jetë e regjistruar si aksionere nga data 17.1.2023, në shoqërinë "Adesta" shpk, pajisur me NUIS (NIPT) ****. Statusi i aktivitetit "aktiv". Bashkëlidhur ndodhet ekstrakti historik i regjistrit tregtar, në të cilën evidentohen zyra qendrore e shoqërisë në Rr. Sali Butka", ndërtesa 13, nr. pasurie *** dhe objekti i aktivitetit "në fushën e ndërtimit". Esi Sulaj figuron ortake me 10% të kuotave të kapitalit themeltar, me vlerë të përgjithshme 100.000 lekë.
- **D.P.Tatimeve** konfirmon se shtetasja Esi Sulaj figuron e regjistruar në organet tatimore si aksionere individ i kompanisë “Adesta”, shpk me NIPT M31317011L, prej datës 17.01.2023.
- **D.R. Tatimore Tiranë** konfirmon se shtetasja Esi Sulaj figuron e regjistruar si Person Fizik, me NIPT ****, prej datës 17.01.2023. Aktiviteti "ndërtim". Subjekti nuk ka dorëzuar deklarata të të ardhurave, pasi nuk është mbyllur periudha tatimore. (Korrigjuar kjo shkresë me postën elektronike dt. 10.7.2023).

- **D. R. Tatimore Tiranë**, me postën elektronike dt. 10.7.2023 deklaroi se shtetasja Esi Edmond Sulaj, me ID ***, rezultoi si aksionere individuale e subjektit "Adesta" shpk. me nr. nipti ***, me 10% të aksioneve.
- **Agjencia e Prokurimit Publik**, konfirmon se subjekti "Adesta" shpk, figuron i regjistruar në SPE në datë 17.01.2023, por nuk rezultoi fitues në ndonjë procedurë prokurimi elektronik.
- Në proces-verbalin e datës 14.7.2023, subjekti u pyet për pjesëmarrjen e vajzës në aktivitetin e mësipërm, nëse përveç kontributit në kapitalin themeltar të kompanisë, ka kryer investime të tjera financiare, si dhe nëse kjo kompani ka marrë pjesë ose është shpallur fitues në prokurimet e fondeve publike të regjistruara pranë APP-së. Subjekti deklaroi se vajza e tij Esi Sulaj, është me profesion arkitekte dhe nuk ka kryer asnjë investim apo pagesë për llogari të kësaj shoqërie tregtare, përveç vlerës së kontributit fillestar prej 10.000 lekë. Shoqëria "Adesta" sh.p.k, nuk ka marrë pjesë në ndonjë procedurë prokurimi dhe/ose ankandë publik, si dhe nuk është shpallur fituese në ndonjë procedurë prokurimi.

✓ *Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e QKB, DPT dhe sqarimet e subjektit.*

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

1. Të ardhura nga paga pranë shoqërisë "Shaga" shpk, për periudhën nëntor 2020 – Qershor 2021. Shuma e të ardhurave 206.699 lekë.

Hetimi administrativ

- Credins Bank konfirmon llogari page në emër të Esi Sulaj dhe kreditimet e pagave gjatë periudhës 11.12.2020 - 28.2.2023, në shumën totale prej 206.699 lekë.
- ISSH, konfirmon të ardhurat e realizuara nga Esi Sulaj gjatë periudhës nëntor 2020 - Korrik 2021, pranë subjektit "Shaga" shpk.
- Të ardhurat e vajzës së subjektit nga paga, për periudhën deri në Mars 2023. konfirmohen në vlerën totale rreth 207.000 lekë.

Në mënyrë të përmbledhur, referuar të dhënave të deklaratës së pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar deri në datë 9.3.2023, si më poshtë:

1. Apartament me sip. totale 98 m², në Tiranë, në emër të Emond Sulaj e Silvana Sulaj. Vlera 15.453.760 lekë. Zotërimi 100% me bashkëshorten.
2. Llogari page në Raiffeisen Bank. Vlera 231.767 lekë. Zotëron 100%
3. Automjet Peugeot në emër të Silvana Sulaj. Vlera 3.000 euro. Zotëron 100%.
4. Llogari në Raiffeisen Bank në emër të Silvana Sulaj. Vlera 121.9 usd. Zotëron 100%.
5. Depozitë në Raiffeisen Bank në emër të Silvana Sulaj. Vlera 2.073.838 lekë. Zotëron 100%.
6. Llogari page në Tirana Bank në emër të Silvana Sulaj. Vlera 79.334 lekë. Zotëron 100%.
7. Llogari kursimi në Tirana Bank në emër të Silvana Sulaj. Vlera 300.266 lekë. Zotëron 100%.
8. Llogari pranë Credins Bank në emër të Esi Sulaj. Vlera 134.259. Zotëron 100 %.
9. Esi Sulaj, kuotë 10% në "Adesta" shpk me NUIUS ***** Kapitali themeltar 100.000 lekë. Vlera 10.000 lekë zotëron 10%.
10. Kartë Krediti pranë Tirana Bank me vlerë limiti 50.000 lekë, në emër të Silvana Sulaj. Detyrimi financiar 0 lekë.

Vlera e pasurisë bruto/neto është 18.283.224 lekë+3000 euro+122 usd e konvertuar rreth 18.640.000 lekë (konvertuar me kursin e këmbimit valutor të Bankës së Shqipërisë në datën 09.03.2023 ku 1 Euro=114.4 lekë; 1 Usd=108.3 lekë)

Hetimi administrativ i kryer nga ILDKPKI dhe Trupa Vlerësuese

- ❖ **Banka e Shqipërisë, BKT , Banka e Bashkuar e Shqiperise, Pro Credit Bank, Banka e Parë e Investimeve, Banka Amerikane e Investimeve, Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, Credins Invest, AK Invest, Easy Pay, Fondi Besa, NOA, Iute Credit, Kredo.al, konfirmojne se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk janë klientë të tyre, cka konfirmohet me deklarinimin.**
- ❖ **Drejtoritë Vendore të ASHIK-së, Librazhd, Mallakaster, Devoll, Korce, Fier, Berat, Lushnje, Pogradec, Gjirokastrë, Krujë, Gramsh, Kucovë, Pukë, Malësi e Madhe, Kukës, Kavaje, Bulqizë, Durrës, Skrapar, Has, Kolonjë, Elbasan, Peqin, Tropojë, Mirditë, Tepelenë, Permet, Dibër, Lezhë, Sarandë, Mat, Vlorë, Kolonjë, Kurbin, Shkodër, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.**
- ❖ **Raiffeisen Invest**, konfirmon se shtetasja Silvana Sulaj ka investuar në Fondin Raiffeissen Invest Euro për periudhën 21.03.2013 -03.10.2013. Bashkëlidhur ndodhet nxjerrja e llogarisë së investimit, vlerë 2.000 euro.
- ❖ Raiffeisen Bank , konfirmon llogarinë e pagës në emër të Silvana Sulaj, në të cilën në dt. 07.02.2012 është kredituar nga N.Q shuma 85.000 euro "kalim për blerje apartamenti sipas kontrates nr. ** rep., nr.** kol., dt. 9.1.2012" dhe në dt. 08.02.2012 ka tërhequr cash shumën 80.000 euro. Diferenca 5.000 euro është transferuar në depozitë. Në dt. 19.03.2013, depozita e maturuar shlyhet në llogari në vlerën 5.125 euro dhe po në të njejtën datë, vlera 2.000 euro transferohet në Raiffeisen Invest (investimi shlyhet në dt. 10.10.2013, në vlerën 2.009 euro).
 - ✓ **Rezulton se burimi i investimit në Fondin Raiffeisen Invest, në v. 2013, ka qenë nga llogaria në Raiffeisen Bank , krijuar me të ardhura nga shitja e apartamentit në v.2012. (trajtuar më lart).**
- ❖ QKB konfirmon se B. A. figuron si administrator në shoqërinë ATF.
- ❖ **Drejtoria e Pergjithshme Detare**, nuk konfirmon mjet lundrues ne pronësi të Edmond Sulaj dhe personave të lidhur me të.
- ↓ **Për të vertetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmerinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesave, u bë analiza e të dhënave të deklaruara nga subjekti me informacionet e ardhura nga institucionet e specializuara, proces nga i cili, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se:**
 - ✓ Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, pasuria totale deri në datë 09.03.2023, është deklaruar bruto/neto 18.283.224 lekë + 3.000 Euro + 122 USD, e konvertuar rreth **18.640.000 lekë.**
 - ✓ Të ardhurat e subjektit nga paga dhe shpërblime konfirmohen në vlerën totale rreth **22.278.000 lekë.**
 - ✓ Të ardhurat e bashkëshortes, nga paga, shpërblime dhe trajnime konfirmohen në vlerën totale rreth **20.041.000 lekë**, si dhe nga pjesëmarrja në trajnime rreth **448.000 lekë.**
 - ✓ Të ardhurat e deklaruara nga subjekti dhe bashkëshortja nga taksa e solidaritetit, janë në vlerën totale rreth 725.000 lekë.
 - ✓ Të ardhurat e vajzës Esi Sulaj, konfirmohen në vlerën totale rreth **207.000 lekë.**

Gjithashtu, si burim financiar subjekti deklaron:

- ✓ Të ardhura dhuratë nga familjarët në vitin 2001, për blerjen e apartamentit, vlera **250.000 lekë**.
- ✓ Huamarrje shtetasit A. R. për blerjen e apartamentit në vitin 2001, vlera **2.000.000 lekë**. (Shlyer)
- ✓ Të ardhura nga shitje/blerje e pasurive të paluajshme në vitin 2003 dhe në vitin 2012, në total rreth **12.750.000 lekë**.
- ✓ Për periudhën Janar 2000 - Mars 2023, referuar treguesve statistikore të INSTAT, janë shpenzuar minimalisht për konsum personal (familjar), rreth **15.000.000 lekë**.
- ✓ Përveç sa me sipër, subjekti ka deklaruar shpenzime mobilimi në vlerën totale rreth **1.000.000 lekë**.
- ✓ Për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, janë shpenzuar për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet etj., në total rreth **152.000 lekë**.
- ✓ Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, janë shpenzuar për udhëtime të subjektit dhe personave të lidhur, në total 2.190 euro, konvertuar rreth **250.000 lekë**.
- ✓ Për periudhën deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, janë shpenzuar për arsimimin e personave të lidhur, në total 374.000 leke + 8.300 euro konvertuar rreth **1.323.000 lekë**.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Ceshtjet e Brendshme dhe Ankesat", ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, bazuar në dokumentacionin administruar, konstatohet se për subjektin Edmond Sulaj;

- a. **Deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- b. **Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- c. **Nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- d. **Nuk është krver deklarim i rremë;**
- e. **Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.**

V. KONTROLLI I FIGURËS

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

- ❖ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre elementë:
 1. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
 2. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
 3. verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, gërma (ë), e ligjit 12/2018, i ndryshuar.
- ❖ Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit **Z. Edmond Reis Sulaj**, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikimit nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

❖ **Për kontrollin e figurës Trupa e Vlerësimit administroi:**

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”.
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore administruar pranë trupës më datë 24.08.2023 me shkresën nr.1495/4 prot datë 23.08.2023

Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti ka deklaruar se:

- Të dhënat e paraqitura në Deklaratën për Kontrollin e Figurës janë të sakta dhe të vërteta.
- Është i vetëdëshëm se mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës për kontrollin e figurës mund të sjell përjashtimin nga detyra, sipas ligjit “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”, të ndryshuar.

Formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit Nr. 12/2018, i ndryshuar. Pas shqyrtimit paraprak të formularit të deklarimit u vendos dërgimi i kërkesës për verifikim të kontrollit të figurës në Drejtorinë e Analizës dhe Kartotekës referuar nenit 42 të ligjit 12/2018 i ndryshuar.

Hetimi administrativ

Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklarimit të subjektin e vlerësimit lidhur me këtë aspekt, janë kryer veprime duke kërkuar të dhëna nga institucionet të shprehura në ligj, referuar nenit 37 të ligjit 12/2018 i ndryshuar, si më poshtë:

- a. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
- b. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- c. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;
- d. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;
- e. Prokuroria e Përgjithshme;
- f. Shërbimit Informativ Shtetëror
- g. Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave
- h. Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit;
- i. Autoriteti kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Kualifikuar;
- j. Avokatit të Popullit
- k. Prokuroria e Posaçme Kundër korrupsionit dhe Krimit të organizuar (SPAK);
- l. Drejtorisë Analizës dhe Sigurimit të Personelit në AMP
- m. Drejtorisë së Inspektimit dhe Ankesave në AMP

Nga informacionet e dërguara nga institucionet e mësipërme konstatohet se:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile konfirmon se nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve.
2. Organ ligjzbatues, konfirmon se për subjektin e vlerësimit Z. Edmond Reis Sulaj, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare:
 - a. Nuk ka të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;

- b. Nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, (sipas përcaktimeve të bera në ligjin Nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar") ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike, etj;
 - c. Nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (persona të dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të Ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar);
 - d. Nuk ka të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një vepre penale;
 - e. Nuk ka të dhëna nëse ka qënë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale;
 - f. Nuk ka të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhëri ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale;
 - g. Nuk ka të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj;
 - h. Nuk ka të dhëna nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATOS-
 - i. Nuk ka të dhëna nëse nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet,
 - j. Nuk ka procedim disiplinor apo masë disiplinore.
3. Organ ligjzbatues, konfirmon se nuk disponon të dhëna.
 4. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve konfirmon se nuk rezulton i dënuar.
 5. Organ ligjzbatues, konfirmon se :
 - a. Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi;
 - b. Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal;
 - c. Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;
 - d. Nuk ka pasur regjistrim të njoftimit të veprave penale;
 - e. Nuk ka pasur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.
 6. Organ ligjzbatues konfirmon se për subjektin e vlerësimit Z. Edmond Reis Sulaj nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.
 7. Organ ligjzbatues konfirmon se, për subjektin e vlerësimit Z. Edmond Reis Sulaj, si dhe personat e lidhur sipas çertifikatës familjare:
 - a. Nuk ka të dhëna/informacione të vertetuara që janë të përfshirë ose të dyshuar për përfshirjen e tyre në krimin e organizuar.
 - b. Nuk ka të dhëna/informacione për kontakte të papërshtatshme.
 - c. Nuk ka të dhëna në lidhje me cënimin e sigurisë kombëtare.
 8. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, konfirmon se ka rekorde financiare për subjektin, bashkëshorten dhe vajzën e tij.
 9. Organ ligjzbatues, i cili konfirmon se subjekti është i pajisur me certifikatë sigurie "Tepër Sekret" të vlefshme deri më 11.07.2027 si dhe nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror", të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.
 10. Avokati i Popullit, konfirmon se nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës, si dhe nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.
 11. Organ ligjzbatues, nuk ka qënë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit, deri 2 Korrik 1991.

12. Drejtoria së Analizës dhe Sigurisë të Personelit në AMP, Drejtoria së Inspektimit dhe Ankesave në AMP, e cila bën me dije se:

- ❖ Me shkresën nr.** Agjencia e Mbikëqyrjes Policore ka referuar në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, materialin kallëzues në ngarkim të disa punonjësve policie, midis të cilëve edhe për subjektin Edmond Sulaj, në atë kohë me detyrë Specialist në Sektorin Kunder Krimeve të Rënda, në Drejtorinë Kundër Krimëve të Rënda, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasi kanë kryer verifikime të pa autorizuara në sistemin TIMS për një shtetas të huaj i shpallur në kërkim kombëtar. Për këtë arsye kanë qënë të dyshuar për veprat penale "Tregtimi i sekretit shtetëror nga personi që i është besuar" dhe "Shpërdorimi i detyrës", të parashikuara nga nenet 294/2 e248 të Kodit Penal pasi këto të dhëna janë akspojuar më pas në media.

Hetimi administrativ

- Me shkresën nr.*** datë 10.10.2023 trupa e vlerësimit i ka kërkuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë informacion në kuadër të procesit të vlerësimit në lidhje me pezullimin e hetimeve për veprën penale të sipërpërmendur dhe kjo e fundit në përgjigje të saj me shkresën nr.*** datë 31.10.2023 ka informuar Relatorin se procedimi penal rezulton të jetë i regjistruar pa emër personi të regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale dhe marrë vendim për pezullim të hetimeve. Nuk disponohet një kopje e vendimit të pezullimit pasi është dërguar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë, Tiranë, me nr. *** prot, datë 28.10.2014.
- **Trupa e vlerësimit ka kryer verifikimet përkatëse pranë sektorit të kartotekës duke u vënë në dijeni me të gjithë dosjen e klasifikuar sekret shtetëror; mori kontakt me oficerin e policisë gjyqësore, përgjegjës i referimit të çështjes, i cili konfirmon se nuk ka asnjë informacion të verifikuar ndaj subjektit.**
- Konfirmohet gjithashtu nga struktura përgjegjëse se çështja është kthyer për zbulim autori nga ana e prokurorisë, në Drejtorinë Rajonale të AMP, Tiranë e cila ka arshivuar dosjen pa prova e fakte të reja.

Në bazë të informacionit të dërguar nga institucionet përgjegjëse, Trupa e vlerësimit konstatoi se:

- a) Punonjësi nuk ka kryer deklaram të rremë;**
- b) Nuk ka informacione të dhëna të vërtetuara nga agjencitë ligjzbatuese që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar;**
- c) Nuk ka informacion në deklarimin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.**

❖ Testi për përdorim lëndësh narkotike:

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38, të Ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se: **nuk u zbulua** prania e produkteve të metabolizmit të MOP (opiate/heroine), COC (kokaine), MTD (metadon), THC (canabioide/cannabis sativa), BARB

(barbiturate), TCA (triciklike antidepressantë), AMP (amfetaminë), MDMA (ekstazi), LSD (acid lisergjik), BZO (benzodiazepina).

VI. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

- ❖ Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar si dhe legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Policisë së Shtetit.
- ❖ Me shkresën nr.12/8 prot., datë 19.03.2023, trupa e vlerësimit ka dërguar formularin e vlerësimit të aftësive profesionale pranë DPPSH.
- ❖ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:
 - Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
 - Raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore pranë DPPSH.
- ❖ Subjekti i vlerësimit **Edmond Reis Sulaj** në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e “Drejtor i Drejtorisë për Krimet Kundër Personit dhe Pasurisë ”
- ❖ Me Urdhërin nr. 3023, datë 29.06.2023, është transferuar në detyrën si Drejtor i Drejtorisë për Hetimin e Krimeve të Rënda
- ❖ Me Urdhërin nr. 6108, datë 11.10.2023, transferohet në detyrën Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, pozicion të cilin e mban aktualisht.
- ❖ Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me shkresën nr. 2645/51 prot., datë 30.06.2023 ka dërguar Raportin Përfundimtar të aftësive profesionale të **Z.Edmond Reis Sulaj**, i datëlindjes 08.07.1973 administruar pranë AMP me nr 12/11 prot., datë 05.07.2023.

Subjekti i vlerësimit Edmond Reis Sulaj në formularin e vetëvlerësimit profesional ka deklaruar sa vijon:

- ❖ Të dhënat identifikuese:

Në këtë seksion subjekti i vlerësimit ka plotësuar të dhënat; emër, atësi, mbiemër, gjinia, data e lindjes, vendi i lindjes, shteti i lindjes, shtetësia, numrin personal, adresën elektronike e-mail-i zyrtar, adresë tjetër elektronike, numër telefoni celular.

- ❖ Të dhënat për punësimin

Sipas formularit të vetëdeklarimit profesional (Shtojca 3) subjekti i vlerësimit Edmond Reis Sulaj ka deklaruar të dhënat si vijon:

Data e fillimit	Data e përfundimit	Institucioni	Funksioni	Emer/ mbimer i punëdhënësit apo eprorit të drejtpërdrejtë	Adresa e plotë e institucionit	Arsyeja e largimit
12/10/2023	Aktualisht	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	Drejtor i Drejtorisë Vendore Shkodër			

16/06/2023	11/10/2023	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	Drejtor i Drejtorisë për Hetimin e Krimeve të Rënda		Bulevardi Bajram Curri	Transferuar për nevoja pune
19/12/2022	Aktualisht	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	Drejtor i Krimeve Kundër Personit dhe Pasurisë	Drejtues i Lartë Neritan Nallbati	Bulevardi Bajram Curri	-
19/10/2021	18/12/2022	Drejtoria Vendore e Policisë Kukës	Drejtor i Policisë Vendore	Drejtues Madhor Gledis Nano, më pas Drejtues Madhor Muhamet Rrumbullaku	Rruga "Riza Sulë Elezi", Kukës	Transferuar për nevoja pune
18/06/2018	18/10/2021	Drejtoria e Antiterrorit	Zv/Drejtor	Drejtues i Parë Gledis Nano	Rr "Sabri Koçi", Tiranë	Transferuar për nevoja pune
07/03/2018	17/06/2018	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	Shef Sektori i Krimeve Kundër Personit	Drejtues Arben Dashi, më pas drejtues Niko BrahiMaj	Bulevardi "Bajram Curri"	Transferuar për nevoja pune
19/10/2017	06/03/2018	Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan	Zv/Drejtor i komanduar	Drejtues Altin Qato	Rr. "Koço Brisku"	Rikthyer në detyrën e Shefit të Sektorit

❖ Të dhëna për vetëvlerësimin profesional

Në këtë seksion subjekti i vlerësimit ka deklaruar:

Detyrat e kryera për periudhën e përcaktuar në nenin 44, të ligjit të vlerësimit:

1. Drejtor Kundër Krimeve Ndaj Personit dhe Pasurisë në Departamentin e Policisë Kriminale në DPPSH.
2. Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës.
3. Zv/Drejtor në Drejtorinë e Antiterrorit. Drejtoria e Antiterrorit. Në DPPSH
4. Shef i Sektorit për Hetimin e Krimeve të Rënda Ndaj Personit në Drejtorinë për Hetimin e Krimeve Kundër Personit dhe Pasurisë, në DPPSH.
5. Zv/Drejtor për Hetimin e Krimeve në Drejtorinë Vendore e Policisë Elbasan.

6. Specialist Drejtimi në Sektorin për Hetimin e Krimeve ndaj Pronës, në Drejtorinë për Hetimin e Krimeve Kundër Personit dhe Pasurisë, në DPPSH.
7. Specialist Drejtimi në Sektorin për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafikeve, në Drejtorinë për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafikeve, në DPPSH.
8. Specialist Drejtimi në Sektorin Për Hetimin e Akteve Terroriste, në Drejtorinë për Hetimin e Krimeve Kundër Akteve terroriste, Personit dhe Pasurisë, në DPPSH.
9. Shef Seksioni për Hetimin e Akteve Terroriste, në Drejtorinë Vendore e Policisë Tiranë.

❖ **Arsimi i kryer dhe përputhshmëria me kriteret e pozicionit të punës**

Subjekti ka plotësuar arsimimin si më poshtë:

- Kam përfunduar studimet në sistemin 3 (tre)vjeçar me shkëputje nga puna në Akademinë e Rendit Publik i cili është në përputhshmëri me kriteret e pozicionit të punës.

❖ **Kualifikimet në lidhje me pozicionin aktual të punës**

- Certifikatë nga misioni policor "Pameca", trajnim 4 mujor për gradën Nënkomisar Qendra për krimin e Organizuar KCM, Ankara.
- Certifikatë për rritjen e njohurive për Hetimin e Krimin të Organizuar.
- Certifikatë trajnimi për menaxhimin policor OCTN, Sarajevë, Bosnjë Hercegovinë.
- Certifikatë trajnimi për menaxhimin policor OCTN, Zagreb, Kroaci.
- Certifikatë për menaxhimin policor të operacioneve speciale.
- Certifikatë, mbrojtja e të drejtave të viktimave të trafikimit njerëzor.
- Certifikatë trajnimi për menaxhimin e informacionit kriminal.
- Certifikatë për ngritjen e kapaciteteve në nivel lokal mbi çështje të trafikimit.
- Certifikatë trajnimi për teknikat e hetimit të vjedhjeve.
- Certifikatë trajnimi për metodat bashkëkohore të intervistimit të të miturve.
- Certifikatë trajnimi për metodat bashkëkohore të intervistimit të të dënuarve.
- Certifikatë intervistimi i viktimave dhe dëshmitarëve.
- Certifikatë trajnimi Lufta Kundër Terrorizmit.
- Certifikatë trajnimi për metodat e përdorura në Luftën Kundër Terrorizmit, TIKA, Agjensia Turke e Bashkëpunimit ndërkombëtar.
- Certifikatë "Zbatimi i ligjit, forcimi i lidhshimit, taktikat e zbatimit dhe mbijetesat në rrugë". Akademia ILEA, Budapest, Hungari.
- Certifikatë trajnimi për luftën kundër terrorizmit dhe elementët e ndërhyrjes në pengmarrje. Pekin, Kinë.
- Certifikata trajnimi për metodat e hetimit të veprimtarisë së luftëtarëve të huaj terroristë.

❖ **Vlerësimi i aftësive individuale të punës dhe masat disiplinore, për periudhën e përcaktuar në nenin 44 të Ligjit të vlerësimit (Vlerësimi me pikë)**

- Viti 2017, 28 pikë,
- Viti 2019, 28 pikë,
- Viti 2020, 28 pikë,
- Viti 2021, 28 pikë,
- Viti 2022, 100 pikë.

❖ **Pjesëmarrja në konferenca shkencore, ëorkshope, botime brenda ose jashtë vendit**

E pa aplikueshme

Hetimi administrativ:

Për të vlerësuar aftësinë profesionale për subjektin e vlerësimit, janë kryer verifikime duke kërkuar të dhëna :

- Të dhënat e administruara ne dosjen personale te subjektit;
- Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Sistemi RMIS;
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit ne formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të Nenit 44, pika 1, Ligjit nr. 12/2018, (i ndryshuar) të mbështetura në dokumentacionin shoqërues të ofruara nga vetë subjekti;
- Të dhënat e siguruara nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi Performancën e subjektit;
- ❖ Të dhënat e siguruara nëpërmjet burimeve të mësipërme, konfirmojnë nivelin arsimor, ecurinë në karrierë dhe gradë, trajnimet, kualifikimet, vlerësimet individuale të punës si dhe performancës e konstatuar gjatë kontrolleve, inspektimeve apo ankesave në drejtim të subjektit nga Drejtoria e Standardeve Profesionale apo institucione te tjera mbikëqyrëse (Avokati i Popullit, Komisioneri për të Drejtat e Njeriut, Komisioneri Kundër Diskriminimit, KLSH).

Nga shqyrtimi dhe analizimi i burimeve të mësipërme, mbi të cilat është mbështetur ky raport vlerësimi, konstatohet:

I. Arsimi

- ❖ Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimit dhe përshtatshmëria me kriteret e pozicionit të punës, sipas parashikimit të nenit 45 pika 21.a e ligjit 12/2018, të ndryshuar.

Sipas të dhënave të administruara në Dosjen Personale të Subjektit, rezulton së subjekti ka përfunduar arsimin e lartë

Niveli i arsimit	Institucioni ku janë ndjekur studimet	Fillimi	Përfundim	Vendi	Titulli/ Diploma
Sistemin-3 vjecar	Akademia e Policisë	1994	1997	Tiranë	Diplomë

- Në kuptim të ligjit Nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar rezulton se subjekti, **Përbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që ushtron pranë Policisë së Shtetit. në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.**

CERTIFIKATAT E TRAJNIMEVE, KUALIFIKIMEVE DHE MEDALJET:

Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale të subjektit, rezulton se ka kryer trajnimet/specializimet si vijojnë:

Nr.	Viti	Emërtimi i trajnimit	Lloji i dokumentit
1.	2000.	Kurs për njohjen dhe përdorimin e kompjuterit.	Certifikatë
2.	2000	Kurs këshillimi dhe trajnimi dy javor.	Certifikatë
3.	2000	Kurs për vendngjarjet..	Certifikatë
4.	2002	Korrupsioni dhe Policia.	Certifikatë
5.	2004	Per hetimin e krimeve financiare.	Certifikatë
6.	2004	Marrjen e gradës N/Komisar.	Certifikatë
7.	2007	Kurs trajnimi për teknikat e marrjes në pyetje në intervistë.	Certifikatë
8.	2008	Roli i Policisë së Shtetit në zbatimin e legjislacionit Kundër Dhunës në Familje.	Certifikatë
9.	2008	Hetimet e Krimin të Organizuar.	Certifikatë
10.	2008	Seminar II Kroacia.	Certifikatë
11.	2008	Rritja e Nivelit të njohurive për Hetimin e Krimin të Organizuar.	Certifikatë
12.	2008	Seminari II Sarajevo -Bosnje dhe Hercegovinë	Certifikatë
13.	2009	Mbrojtja e të Drejtave të Viktimave të Trafikimit të Qenieve njerëzore.	Certifikatë
14.	2009	Trajnimi i Punonjësve të Policisë për përdorimin e Sistemit inf.Kriminal MEMEX.	Certifikatë
15.	2011	Kursi i teknikave të hetimit të krimeve.	Certifikatë
16.	2012	Kursi i intervistimit të dëshmitarëve të viktimave	Certifikatë
17.	2014	Metodat e përdorura në kursin Kundër Terrorizmit	Certifikatë
18.	2015	Lidershipin e zbatimit të ligjit	Certifikatë
19.	2015	Përkujtimore të shërbimit të hetimit kriminal të Policisë së Republikës së Hungarisë.	Certifikatë
20.	2018	Forumi Ekzekutiv mbi konsultimin për Luftëtarët e Huaj Terroriste.	Certifikatë
21.	2019	ëorkshop mbi përdorimin e teknologjisë nga terroristët.	Certifikatë

Gjithashtu gjatë karrierës rezulton se subjekti ka marrë disa shpërblime për performancë të lartë në realizimin e detyrave.

- ✓ Nga verifikimi i të dhënave të administruara në dosjen personale të punonjësit, rezulton se **Deklarimi i subjektit të vlerësimit është i saktë.**

II. Vlerësimet e punës

Në dosjen personale të subjektit, për periudhën 2018-2023 rezulton së janë të administruara 5 (pesë) vlerësime të aftësive individuale të punës në të cilat është vlerësuar si vijon:

Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2018	28 Pikë	(shumë mirë)
Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2019	28 Pikë	(shumë mirë)
Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020	28 Pikë	(shumë mirë)
Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021	28 Pikë	(shumë mirë)
Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2022	98 Pikë	(shumë mirë)

Në periudhën 2019 — 2021 vlerësimi maksimal i punonjësve sipas formularit të vlerësimit ishte me 28 pikë, ndërkohë nga viti 2022 e në vazhdim vlerësimi maksimal është 100 pikë.

- ❖ Vlerësimi i aftësive individuale të punës sipas standardeve të përcaktuara bëhet nga eprori i drejtpërdrejtë, bazuar në vlerësimin e integritetit, profesionalizmit, komunikimit, qëndrimit konstruktiv, paanshmërisë, punës në grup si dhe planifikimit dhe organizimit të punës.
- ✓ Bazuar në vlerësimet e mësipërme të administruara në dosjen personale të subjektit, rezulton se **subjekti ka përmbushur detyrat profesionale, ka respektuar rregullat e etikës si edhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerien e detyrave funksionale.**

III. Masat disiplinore

Nga verifikimi i dosjes personale të subjektit të vlerësimit rezulton se nuk ka asnjë masë ndëshkuese në fuqi.

IV. Ecuria në karrierë.

- Nga verifikimi i sistemit RMIS dhe dosjes personale të subjektit rezulton se gjatë periudhës 5 vjeçare objekt deklarimi, subjekti Edmond Sulaj, ka ecurinë në karriere si vijon:
 - a. Transferuar, Drejtor i Drejtorisë për Hetimin e Krimeve të Rënda, në DPPSH me Urdhërin nr.3023 datë.29.06.2023, aktualisht.
 - b. Transferuar, Drejtor i Krimit kundër Personit dhe Pasurisënë DPPSH, me Urdhërin nr.1076/2 datë 16.12.2022.
 - c. Emëruar Drejtor i Policisë Vendore Kukës me Urdhërin nr.1499/1, datë 19.10.2021 për periudhën nga data 19.10.2021 deri më 16.12.2022
 - d. Transferuar, Zv/Drejtor, në Sektorin e Hetimit Koordinimit, në Drejtorinë e Antiterrorit, në DPPSH me Urdhërin nr. 287 datë 18.06.2018 - 18.10.2021.
 - e. Transferuar, Shef Sektori për Hetimin e Krimeve të Rënda kundër Personit dhe Veprave të cilësuar me Urdhërin nr.491/1, datë 19.05.2017, për periudhën 01.06.2017-17.06.2018.

Emërtimi i gradës	Arsyeja e ndryshimit	Nr. Urdhrit		
				Deri
Drejtues	Dhënë grada me Vendim Gjyqësor	nr. 316 dt. 24-02-2017	24-02-2017	30-04.2022

Drejtues i parë	Ngritur në gradë	nr. 1076 dt. 05-05.2022	01-05-2022	
------------------------	------------------	-------------------------	------------	--

- ✓ Në përfundim, në lidhje me ecurinë në gradë dhe në karrierë të **Z. Edmond Reis Sulaj** rezulton se, funksionet në të cilat është emëruar subjekti si dhe gradat që ai ka përfituar gjatë karrierës, janë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

PJESËMARRJA NË KONFERENCA SHKENCORE ËORKSHOP-E SEMINARE BOTIME BRENDA DHE JASHTË VENDIT

Subjekti, në formularin e vlerësimit të aftësive profesionale ka deklaruar se nuk është angazhuar në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit.

- ❖ Në përfundim të procesit të vlerësimit të aftësive profesionale trupa e vlerësimit konstatoi se subjekti është “I përshtatshëm” për ta ushtruar funksionin që mban.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti i vlerësimit Edmond Sulaj, në përputhje me nenin 60 të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë,
- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës,
- Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të ligjit nr. 12/2018 (të ndryshuar)

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit **Z. Edmond Reis Sulaj me funksion Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.**

2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.

3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, (të ndryshuar).

4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, sot më datë 18.12.2023.

TRUPA E VLERËSIMIT

Arben Sefaj

Kryesues

Denisa Sina

Relator

Suela Bulku

Anëtar